

**E PRANOVA ISLAMIN,**

**POR...**

**Ç' TË BËJ MË TEJ...?**

**DR. LAURENCE B. BROWN, MD**

**Titulli i origjinalit :** *“Bearing True Witness “ or “Now That I’ve Found Islam, What Do I Do With It?”*

**Autor:** Dr. Laurence B. Brown, MD

**Boton:** Sara Doni

© Të gjitha të drejtat e këtij botimi janë të rezervuara. Nuk lejohet ribotimi i plotë apo i pjesshëm i librit pa lejen me shkrim të botuesit.

**Tiranë, 2008**

## Copyright

Copyright © 2004 Laurence B. Brown.

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Nuk lejohet riprodhimi apo transmetimi i asnjë pjese të këtij libri në çfarëdolloj forme apo me çfarëdolloj mjeti – elektronik, mekanik, duke përfshirë fotokopjimin, regjistrim, internet, apo në çdo lloj depozite informacioni ose sistemi rikuperimi, pa lejen me shkrim të autorit, me përjashtim të rastit në vazhdim, **që është i lejuar**.

## Rishtypja

**Lejohet** pa asnjë shpërblim rishtypja, riprodhimi apo transmetimi i këtij libri me çfarëdolloj mjeti – elektronik, mekanik, duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin, internetin (me email ose website), ose me çfarëdolloj depozite informacioni apo sistemi rikuperimi, **me kushtin që të mos bëhet absolutisht asnjëlloj ndryshimi, shtese apo shkurtime** DHE që faqet e titullit të përmbajnë **titullin, emrin e autorit, shënimin e copyright-it, adresën e website-it të autorit**, si dhe këtë **shënim për rishtypjen** në të njëjtën formë, **ekzaktësisht** si në origjinal. Për të siguruar një riprodhim të saktë, lutemi të kontaktohet autori për kopje kompjuterikë falas të printueshëm të këtij libri (shiko website-in më poshtë).

## Përkthimi

Lejohet përkthimi i këtij libri pa pagesë në çfarëdolloj gjuhe me konditën që:

1. **Të mos bëhet absolutisht asnjë ndryshim, shtesë, apo shkurtime;**
2. Faqet e titullit të përmbajnë **ekzaktësisht** në të njëjtën formë si tek origjinali **titullin, emrin e autorit, shënimin e copyright-it, shënimin e rishtypjes**, si dhe **adresën e website-it të autorit;**
3. Copyright-i i përkthimit t'i kalojë sferës publike njësoj dhe në të njëjtën mënyrë si tek origjinali;
4. DHE që autorit (Laurence B. Brown), t'i jepen kopjet kompjuterike të përkthimit, për t'i përfshirë në website-n e tij.

## Website

Website i autorit të këtij libri është [WWW.LEVELTRUTH.COM](http://WWW.LEVELTRUTH.COM)



## HYRJE

Një nga mësimet e para që kam nxënë që në fillimet e mia si autor, ka qenë si ta lokalizojë subjektin e librave të mi e si të përcaktojë rrethin e lexuesve, për të cilët shkruaja. Në këtë mënyrë, ëndrra vetëm për një libër u tejkalua me botimin e të dytit, si dhe me një të tretë, që mendohet të plotësojë një trilogji.

Ky libër është i dyti në këtë seri.

Libri i parë i kësaj serie është shkruar për të udhëzuar ata që janë në kërkim të fesë së të vërtetës. Ai titullohet “Urdhri i parë dhe i fundit” (Publikimet Amana, website [www.amana-publications.com](http://www.amana-publications.com)) dhe trajton vijimësinë e zbulësës nga Judaizmi te Krishterimi dhe më pas tek Islami.

Ky libër, i dyti i trilogjisë, jep udhëzime për aspektet praktike të fesë islame. Ai u drejtohet të kthyerve në fe si dhe muslimanëve që kanë nevojë të jenë më të qartë për fenë e tyre.

Tani që po shkruaj këtë material, libri i tretë është ende në fazën e planifikimit. Ai do të synojë t’u drejtohet kritikave të shumta e të pandershme dhe shpifjeve të paturpshme kundër muslimanëve dhe fesë islame. Tema të tilla si: poligamia, skllavëria, racizmi, mbulesa e femrave, shtypja e grave, terrorizmi, “fondamentalizmi”, idhujtaria dhe të tjera si këto, do të trajtohen me të njëjtën metodologji, si ajo që kam përdorur tek libri me titull “Urdhri i parë dhe i fundit”.

Pra, kjo seri librash është menduar në mënyrë të tillë, që ta tregojë fenë islame si shpalljen e fundit dhe si përmbushjen e parashikimeve të shkrimeve të shenjta çifute e të krishtere (në librin e parë), të sugjerojë si të praktikohet feja islame (në librin e dytë), si dhe t’i sigurojë muslimanit të formuar mbrojtjen nga shpifjet që bëhen më shpesh kundër Islamit (në librin e tretë).

Muslimanët vënë re shpesh, se të kthyerit në fenë islame, kalojnë përmes disa fazave të rritjes ideologjike, shpirtërore dhe psikologjike, përpara se të arrijnë një fasadë të pjekurisë fetare. Periudha e pjekurisë ndryshon nga një individ te tjetri, njësoj si rezultati përfundimtar. Ka muslimanë që shfaqin një pjekuri fetare të madhe qysh në fëmijëri; ka të tjerë që e jetojnë në mosha të mëdha përmbysjen dramatike të pikëpamjeve të tyre. Shembuj të mirënjohur në këtë drejtim janë Imam El-Gazaliu i famshëm në shekullin XI

(emri i plotë - Abu Haamid Muhammad Al-Ghazali ) që e mohoi sufizmin ekstrem në moshë tepër të shtyrë, apo El-Esh'ariu në shekullin X (emri i plotë - Abu Al-Hasan ' Ali ibn Ismaa'eel al-Ash'aree, të cilit i vishet doktrina Esharite), që hoqi dorë nga gabimet e tij në *akide*, duke qenë dhe ai në moshë të thyer. Shembulli më i mirë në këtë drejtim në historinë e kohëve moderne është kalimi i Malkom X-it nga kulti politiko-ideologjik racist, që njihej me emrin “Kombi Islam”, tek Islami (Suni).

Në fillim, të kthyerit në muslimanë u futen rrugëve ideologjike nga më të çoroditurat, ndërkohë që ngjitin nëpër mugëtirë shkallën që i çon përtej humnerës, që ndan pastërtinë e kristaltë të korrektësisë nga terri gjithë mjegull i devijimit. Megjithëse shumë prej tyre ia dalin më në fund ta gjejnë rrugën korrekte të Islamit, ka shumë të tjerë që konfirmohen si devijues të shkallëve të ndryshme, ndonjëherë vetëm në gjëra të vogla, që kanë nevojë thjesht për këshillim, e herë të tjera për gjëra të mëdha, që meritojnë ndëshkim sipas *shariatit* (Ligjit Islam). Por ndodh shumë shpesh, që ato të jenë aq shumë serioze, sa e zhvlerësojnë fare *shehadetin* (dëshminë e besimit) të një njeriu. Si rezultat, ky njeri, pavarësisht nëse e di apo jo, i heq çdo bazë pretendimit të tij për qënien musliman dhe i largohet fare fesë islame.

Rëndësia e saktësisë së rrugës fetare për një individ, lidhet me shpëtimin e tij, kurse rëndësia e saj për komunitetin, lidhet me gabimet e devijuesve e të atyre që e përfaqësojnë keq fenë Islame, në tërësi, duke krijuar keqkuptime rreth saj.

Si qytetar perëndimor i kthyer në Islam, vetë autori i këtij libri e ka jetuar hedonizmin e shkujdesur, që shoqëron mungesën e besimit, zgjimin e vetëdijes shpirtërore në zemrën e kërkuesit, kërkimin pasionant të së vërtetës, analizën e kujdesshme të feve për vlera e faktorë të qëndrueshëm, paqen e përqafimit të së vërtetës së gjetur, kohët e këndshme e të pakëndshme, që vijnë më pas, si dhe gjithë stacionet e tjera të këtij procesi. Jeta dhe veprimtaria si musliman në vendet perëndimore të Amerikës e Anglisë e, më vonë, edhe në Qytetin e Shenjtë të Medinës Al-Munawara, e ka pajisur atë me një përvojë të madhe, që mund t'i ngjallë interes kujtdo që është në kërkim të një rruge të tillë.

Sidoqoftë, ajo që vijon më tej, është më shumë një analizë sesa një libër kujtimesh. E vërteta është se dijetarët muslimanë i kanë trajtuar çështjet që diskutohen në të, qysh në kohën e shpalljes, dhe udha e drejtë për secilën prej tyre është përcaktuar qysh në kohën e Profetit të fundit, Muhamedit (a.s.). Megjithatë, pamjaftueshmëria e informacionit në gjuhën angleze, bën që shumë nga të kthyerit perëndimorë në Islam, të jenë të keqinformuar e, për pasojë, lehtësisht të gabueshëm.

Informacioni që vijon, është përpjekja më e mirë që mund të bëjë autori për ta ndryshuar këtë gjendje të mjeruar.

## 1. ANGAZHIMI

Pasi ka bërë zgjedhjen, çdokush mund të futet në Islam e të bëhet musliman me anë të *shehadetit* ose dëshmisë së besimit. Kjo dëshmi (e transliteruar nga arabishtja) përmban fjalët: “*Esh-heduen la ilahe ilallah ue esh-hedu en e Muhameden Resulullah*”, që do të thotë: “Dëshmoj se nuk ka zot tjetër (përkthehet edhe ‘nuk ka asgjë që ia vlen të adhurohet’), përveç Allahut dhe se Muhamedi (a.s.) është i Dërguari i Tij”.

Në shumicën e rasteve është traditë që *shehadeti* të shpallet në publik, për faktin se, në përgjithësi, të kthyerit në Islam duhet ta bëjnë të ditur këtë kthim të tyre. Megjithatë, kur e kërkojnë rrethanat, *shehadeti* mund të deklarohet edhe përpara Krijuesit, si Dëshmitar i Vetëm.

*Shehadeti* vërteton Njësimin Hyjnor dhe Profetësinë e Muhamedit (a.s.). Ai e angazhon besimtarin në gjithçka të urdhëruar në fe dhe e largon nga gjithçka të ndaluar prej saj. Kështu, megjithëse kjo shpallje nuk thotë asgjë për ndalimin e prostitucionit, tradhtisë bashkëshortore, alkoolit etj, pranimi i ndalimit të tyre lidhet në mënyrë të pazgjydhshme me *shehadetin*, dhe kjo për faktin se njohja e Muhamedit (a.s.) si Profet, pra dhe si i fundit i Profetëve, e bën të detyrueshëm pranimin e mesazhit dhe të ligjeve që janë shpallur përmes tij. Çdo gjë tjetër që është më pak se kaq, është thjesht një hipokrizi.

Pas kësaj, detyra e parë e të kthyerit në Islam, është të kuptojë mirë thelbin e *shehadetit* dhe të nisë të jetojë me të.<sup>1</sup> Për këtë subjekt janë shkruar shumë libra të shkëlqyer dhe ka pak gjëra, për të mos thënë aspak, që mund t’u shtohen veprave të hershme. Megjithatë, një informacion i shkurtër rreth tyre, mbase do të ishte i nevojshëm. Së pari, angazhimi më i rëndësishëm kur shpallet *shehadeti*, është njohja e monoteizmit (Njësimi i Allahut, të cilën e shpreh fjala arabe, *tevhidi*). Këtij momenti nuk i përshkruhet dot asnjëherë rëndësia që meriton vërtet. Islami është feja e *tevhidit*. Çdo kompromis në dëm të monoteizmit islam dhe çdo kompromis në kurriz të supremacisë dhe Njësimit Absolut të Allahut, përbën një *shirk*. *Shirku* ekziston në gradë të ndryshme - që nga *shirku* më i madh, që e nxjerr njeriun nga Islami, tek *shirku* më i vogël, i cili konsiderohet ndër mëkatet më të mëdha, e deri te *rijaja* ose *shirku* i fshehtë. Shembuj të *shirkut* të madh janë adhurimi i tjetërkujt, përveç Allahut, apo t’i bashkosh partnerë në adhurim Allahut. Në shembujt e *shirkut* të vogël futen betimi për tjetërkënd, përveç Allahut, apo besimi tek hajmalitë që sjellin “fat”. Së fundi, shembuj të *shirkut* të fshehtë janë zburimi i lutjes për hir të dikujt, që dihet se është duke të shikuar, ose dhënia lëmshë më shumë nga ç’mund të jepej në kushte të tjera, vetëm sepse e di që dhurimin po e vëzhgon dikush. Pikërisht, për shkak të rëndësisë së madhe që kanë *tevhidi* dhe *shirku*, këshillohet së tepërmi, studimi i mëtejshëm i librave që merren me trajtimin e tyre.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Dijetarët thonë se *shehadeti* nuk është i vlefshëm nëse mungojnë shtatë elementë: dija, sinqeriteti, ndershmëria, dashuria për *shehadetin*, siguria, largimi nga gjithçka që mohon *shehadetin* si dhe praktikimi.

<sup>2</sup> Libra të tillë janë gjerësisht të disponueshëm në një shumëllojshmëri librarish islamike.

Në funksion të *tevhidit*, është dhe shpallja e Muhamedit (a.s.) Profet dhe i Dërguar i fundit i Islamit - një njohje kjo, me një rëndësi të veçantë, për shkak të faktit se në kohë të ndryshme ka pasur pretendentë të shumtë mesianikë, që kanë dalë me pretendime të rreme për profetësi, duke i çoroditur masat dhe duke i futur në lloj-lloj udhësh të devijimit, që vazhdon dhe sot e kësaj dite. Elija Muhamed, themeluesi i “Kombit Islam”, është vetëm njëri nga këta shembuj. Të tjerë nga kjo farë të çoroditurish e çoroditësish janë Mizra Gulam Ahmedi, themeluesi i sektit *Ahmedije*, (që njihen edhe me emrin *Kadiani*), Mirza Ali Muhamedi dhe Mirza Hysen Aliu (themelues të sektit *Bahaj*), si dhe një varg pretendentësh të tjerë mesianikë anormalë dhe të ngjyrave nga më të ndryshmet, por gjithsesi me influencë, që janë shfaqur në 1400 vitet e fundit. Shpallja e Muhamedit (a.s.), si Profet i fundit i Allahut, i mbyll të gjitha shtigjet për marrjen parasysht të pretendimeve të tilla të rreme. Për më tepër, plotësimi i zinxhirit të profetësisë nëpërmjet Muhamedit (a.s.), është në pajtim me parashikimet e shkrimeve të shenjta të mëparshme (për sqarime më të plota lexuesi mund t’i referohet “*Urdhrit të Parë dhe të Fundit*”, librit të parë të serisë).

Së fundi, në deklaratën e *shehadetit* nënkuptohet pranimi i bazave të besimit islam (që njihen si “shtylla”, për faktin se pa këto shtylla të besimit e të praktikës, angazhimi në fe është i dështuar). Çdo librari e zakonshme islame ka në listat e saj një numër librash që përkufizojnë shtyllat e besimit e të praktikës islame. Librat që mund të gjenden, qofshin broshura të vogla apo volume gjithëpërfshirëse, ofrojnë trajtime nga më të thjeshtat, e deri tek më akademiket. Shkurtimisht, gjashtë shtyllat e besimit janë: Besimi tek Allahu, besimi tek Engjëjt e Tij, tek Shkrimet e Shenjta, Profetët, Jetën pas vdekjes dhe në Urdhrin hyjnor. Detyrat që kërkohen për adhurimin janë pesë: Deklarimi i besimit kur hyhet në Islam (d.m.th. *shehadeti*), falja pesë herë në ditë (në intervale të përcaktuara sipas rregullave të faljes e të pastrimit), agjërimi i përvitshëm i muajit të Ramazanit, pagesa e përvitshme e taksës për të varfërit, si dhe kryerja e pelegrinazhit në Mekë, gjatë periudhës së *Haxhit* një herë në jetë, nëse ekzistojnë mundësitë financiare dhe fizike.

Kjo është e gjitha! Vetëm thuaj *shehadetin*, përvetëso besimet dhe praktikat dhe kështu, e ke nisur udhën tënde. E lehtë, apo jo? Përgjigjja më e përshtatshme e kësaj pyetjeje do të ishte: “Po dhe jo!” Nëqoftëse ka ndonjë pikë me rëndësi përcaktuese, që u duhet bërë e ditur muslimanëve të rinj, është kjo: Islami është fe që ka strukturë. Çdo parim, çdo mësim, çdo besim dhe çdo element i vlefshëm i fesë islame bazohet në realitet. Kur muslimani thotë diçka për fenë islame, duhet të jetë në gjendje që ta mbështesë fjalën e tij me fakte. Standarti i artë (që është dhe standarti i vetëm i pranueshëm) i ligjshmërisë islame, duhet gjetur nga ata që kanë njohuri të plota (d.m.th. nga dijetarët muslimanë), përmes interpretimit të dëshmimeve islame. Pra, cilat janë burimet e dëshmimeve islame? Vetëm dy: Fjala e zbritur e Allahut (Kurani i shenjtë) dhe Suneti (rruga e profetit Muhamed (a.s.), që nënkupton mësimet dhe shembullin e tij, siç komunikohen nga fjalët, veprimet, dukja e jashtme dhe miratimet e nënkuptuara të tij, të ruajtura, të gjitha këto, në traditat islame që njihen me emrin *hadith*). Si përfundim, çdo mësim i vlefshëm ka një bazë në dëshmitë islame, dhe, pavarësisht nëse të pëlqen apo jo, këto dëshmi duhet të

jenë të qarta, të pranishme e të vërtetuara, në mënyrë që çdo mësim i veçantë, të konsiderohet i pranueshëm.

Pra, sa herë që mëson diçka nga një musliman tjetër, pavarësisht nëse të pëlqen a s'të pëlqen dhe është apo s'është i respektuar, pyetja vendimtare për këdo mësues e cilindo mësim, është vetëm kjo: “Ku e ke marrë këtë informacion?” Dhe nëse është thjesht sepse ashtu e mendon një individ, atëherë bëj kujdes! Është pikërisht në sajë të këtyre udhëve të rrëshqitshme të fantazimit dhe opinionit, që masat janë futur në të kaluarën në rrugë të gabuar. Rrugë të tjera që të shpien në gabime janë dhe këto:

**1. Misticizmi.** Le të ndalemi për pak në këtë çështje. Pritet që devotshmëria fetare dhe virtyti, të shpien në një nivel të caktuar të shikimit të brendshëm dhe të kuptimit të thelluar të çështjeve fetare. Por, edhe pse s'ka asgjë të keqe të kërkosh njohuri të tilla, besimtarët bien në gabime kur i kushtojnë këtij procesi, përpjekje aq të sforcuara, sa lënë mënjanë rregullat e udhërrëfimit, që ka diktuar Krijuesi, për ca rregulla të tjera, të sajuara nga një qenie njerëzore, siç është, për shembull, mistiku. Treguesi më kritik i devijimit në misticizëm, është pikërisht përqaftimi i mësimëve dhe i praktikave, që nuk bazohen në burimet e pranuar të ligjit islam, që janë Kurani, Suneti dhe interpretimet që kanë bërë nëpërmjet tyre dijetarët e respektuar suni. Çështja është më e qartë kur hasen mësim të pabaza e udhëheqës shpirtërorë, që shpallin me bujë pretendime vetëmadhëruese për njohje superiore shpirtërore, me të cilën rreken të përlligjin besime dhe praktika të çuditshme e të pathemelta. Po ajo nuk është e qartë në mjaft raste të tjera, kur shumë devijues që keqduhëzojnë, i referohen Kuranit dhe Sunetit për të mbështetur besimet e tyre të gabuara. Shpesh, fakti që devijues të tillë keqinterpretojnë dhe keqçitojnë Kuranin, apo kapen pas haditheve të pavërteta për të mbështetur qëndrimet e tyre, nuk u bie në sy atyre që nuk zotërojnë mjetet intelektuale, që duhen për të dalluar burimet autentike, të interpretuara në mënyrë korrekte, nga burimet e manipuluar ose joautentike.

Për diskutim të mëtejshëm të këtij problemi, mund të lexoni kapitullin e pestë, me titull “Sufizmi”.

Shtigje të tjera që shpien në gabim janë:

**2. Filozofia** - Sepse filozofët s'pajtohen me njëri-tjetrin, kështu që e shumta, vetëm njëri nga drejtimet e tyre, mund të jetë në të drejtë. Dhe, për këtë çështje, shikoni se çfarë u ka ndodhur grekëve!

**3. Racionalizmi** - Sepse në fe jo çdo gjë ka “kuptim” për çdo njeri, kështu që prirja për të përzgjedhur e modifikuar standartet fetare vetëm sepse “nuk kanë kuptim” sipas dikujt, shpie në devijime dhe, jo rrallë herë, edhe në mosbesim. Zakonisht, përpjekjet për të racionalizuar pikëpamjet e devijuesve, vijnë prej atyre që duan ta modifikojnë fenë në mënyrë të atillë që t'u përshtatet dëshirave të tyre. Shembujt më klasikë janë përpjekjet për “modernizimin” apo “përshtatjen” e Islamit.

**4. Super-intelektualizmi** - Pritet që muslimanët të mendojnë e arsyetojnë jo vetëm duke synuar arritjen e besimit, në radhë të parë, por edhe për ta praktikuar e zbatuar fenë ashtu siç duhet. Por intelektualizmi mbart kufizime praktike, që do të thotë se ka gjëra që njerëzit vetëm sa duhet t'i pranojnë, besojnë e zbatojnë -



urdhurat e Allahut, për shembull. Nëse njerëzit do refuzonin të pranonin, mbështesnin e përmbushnin një urdhër të Allahut, vetëm se nuk mund ta kuptojnë logjikën e tij, ata do të binin në mosbindje dhe gabim.

**5. Justifikimet e rreme** - Si ato që bëhen përmes keqcitimit apo keqinterpretimit të vargjeve kuranore, ose kur përdoren hadithe të dobëta e të sajuara, në mbështetje të një qëndrimi të devijuar.

**6. Gjykimi i një çështjeje, pa patur dijen e duhur.**

Ndërkaq, njeriu mund të jetë i qetë, nëse e merr udhëzimin nga dijetarë të respektuar e të kualifikuar, që i nxjerrin mësimet e tyre nga Kurani i shenjtë dhe hadithet autentike.

Askush nuk mund ta quajë veten të sigurtë, nëse nuk mbështetet tek dijetarët e kualifikuar, në përputhje me dëshmitë themelore të Kuranit e Sunetit. Po ta rishikosh historinë, vihet re se njerëzimi u futet rrugëve të gabuara, sa herë që frerët e intelektit njerëzor janë hequr nga duart e dëshmimeve shpëtimtare që ai të lihet i lire në fushat plot shpjegime joshëse. Shembujt më të njohur për këtë, janë kërkimet alkimiste të “gurit filozofik” (për formulën mitike, me anën e së cilës, metalet e zakonshme do mund të ktheheshin në ar), për burimin e pavdekësisë apo për qypat me flori e ëndrrat e çartura të çdo legjende, që nxisin lëshimin e një anijeje, apo nisjen e një ekspedite për kuturisje krejt të kota. Megjithatë, asnjë legjendë e pabazuar, nuk ka çuar deri më sot, në sakrificimin mendjelehtë të aq pasurive, energjive, jetëve e shpirtrave, sa fetë e rreme.

Libri me titull “*Urdhri i parë dhe i fundit*”, zbulon themelet e dobëta, të paqena apo të fabrikuara, pa ndonjë qëllim, të shumë prej miteve të teologjisë moderne judaike apo kristiane. Islami i hedh poshtë hipokrizi të tilla dhe kujdeset për pastërtinë e mësimëve të tij, duke u kërkuar dijetarëve që ta nxjerrin *fikhun* nga burimet themelore e të pandryshueshme të fesë islame dhe duke u kërkuar njerëzve, që të ndjekin vendimet që kanë legjitimuar dijetarët e kualifikuar.

Për fat të keq, shumë të sapokthyer në Islam hamendësojnë supozimin tepër optimist, por dhe tmerrësisht naiv, se të gjithë “dijetarët” dinë se për çfarë flasin dhe se të gjithë muslimanët ecin mbi të njëjtën udhë. Asgjë s’mund të jetë më larg së vërtetës sesa kjo! Ka një larmi sektesh që vetidentifikohen me etiketën e Islamit, ndërkohë që në pikëpamje ideologjike, dallohen që nga risitë më të vogla e deri te blasfemitë më të qarta. Disa nga sektet heretike qëndrojnë në kufijtë e përcaktuar qartë të Islamit, ndërkohë që të tjerët janë aq shumë larg rrethinave të tij, saqë meritojnë të kenë një kod të veçantë metafizik postar.

Pra, etiketimi është i nevojshëm.

Në përgjithësi, muslimanët preferojnë që të mos njihen me emër tjetër, përveçse *muslimanë*, për arsyen e thjeshtë se në Kuranin e Shenjtë, Allahu i Madhëruar u referohet besimtarëve pikërisht me këtë emër. Për ata që respektojnë gjithëfuqishmërinë e Allahut, asnjë etiketim i krijuar nga ndonjë mendje njerëzore, nuk mund të konkurojë me atë që ka zgjedhur Zoti. Megjithatë, etiketat janë bërë të nevojshme për dallimin e grupeve të ndryshme. Dy nëndarjet më të mëdha në botën islame, janë sunitët e shiitët. Muslimanët

suni i përmbahen *Sunetit* (rrugës) të profetit Muhamed (a.s.), ashtu siç e ka sjellë tradita islame (Hadithi), kurse shiitët u përmbahen mësimëve të drejtuesve të tyre fetarë (imamëve), pavarësisht nëse një gjë e tillë vërtetohet apo jo nga Kurani dhe Suneti. Siç ndodh rëndom, sa herë që njerëzit u japin përparësi udhëheqësve karizmatikë mbi të vërtetën e shpalljes, ekziston një numër i vogël individësh të çuditshëm, me një ideologji akoma më të çuditshme, të cilët janë futur vjedhurazi në zinxhirin e autoriteteve, në momente të ndryshme të historisë, kanë instaluar devijacionet e tyre në kodin fetar dhe i kanë shkëputur besimet sektare, duke hedhur herë një hap dhe herë një tjetër, për t'u larguar nga e vërteta e fillimeve të Islamit. Prirje të tjera devijatore shkatërrimtare, si ato që janë zhvilluar në zemrat e në mendjet e shiitëve, kanë ndarë efektivisht nga trangu kryesor i muslimanëve suni, një listë të gjatë sektesh të tjera.

Megjithatë, Islami suni përfshin rreth 95 % të të gjithë muslimanëve në shkallë botërore, e kjo për shumë arsye. Para së gjithash, në pikëpamje metodologjike. Ai që pranon Islamin, pohon supremacinë dhe njësimin e Allahut, që shpie vetvetiu në mohimin e çfarëdolloj koncepti të partnerëve apo ortakëve në shenjtëri. Në përkthimin e kuptimeve të Kuranit, thuhet:

***“Prandaj mos sajoni me vetëdije zota të barabartë me Allahun”.*** (Kuran, 2:22),

si dhe

***“Thuaj, “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm. Allahu është Absoluti, të Cilët i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!”*** (Kuran, 112:1-4).

Rrjedhimisht, ka vetëm një autoritet suprem e përfundimtar, e ky është Allahu; pra duhet të respektohet zgjedhja e Tij për Kurandin e Shenjtë si Shpallje të fundit, dhe për Muhamedin (a.s.) si të Dërguar të fundit. Veç kësaj, Allahu e udhëzon njerëzimin në mënyrë të përsëritur në Kurandin e shenjtë, që të ndjekë shembullin e Profetit të fundit dhe t'i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Muhamedit (a.s.). Një herë e vetme do të mjaftonte, por fakti që Allahu e përsërit shpesh këtë porosi në shpalljen e Tij, do duhej të ndërpriste çdo diskutim lidhur me këtë temë.

Nisur nga prioriteti i shembullit të Muhamedit (a.s.) në Islam, është vërtet legjendar përkushtimi dhe rigoroziteti, me të cilin brezat e kaluar kanë ruajtur librarinë e Hadithit. Kjo është arsyeja se pse në histori nuk ka asnjë njeri tjetër, për të cilin të jenë dokumentuar e konfirmuar kaq shumë detaje. Ndryshe nga profilet e mjegulluara të të gjithë profetëve të mëparshëm, jeta, karakteri dhe mësimet e Muhamedit (a.s.), mund të bëhen të njohura deri në hollësitë më të vogla, dhe pikërisht këtyre hollësive, u përmbahen muslimanët suni.

Përkundër kësaj, muslimanët shiitë, janë vetëm njëri nga grupet e një liste të gjatë sektesh devijatore, që kanë zgjedhur të shpërfillin sunetin e Muhamedit (a.s.) në njërin apo në tjetrin drejtim, në favor të mësimëve të udhëheqësve të tyre sektarë. Në mënyrë të ngjashme me kristianët, që hodhën poshtë mësimet ortodokse të Jezu Krishtit, për të

përqafuar teologjinë më liberale, megjithëse të kundërt, të Palit, sektet e devijuara të Islamit, u japin përparësi mësimëve njerëzore, të kundërta me ato që bazohen te Kurani, Suneti dhe interpretimet e dijetarëve të kualifikuar mbi bazën e tyre.

Fatkeqësisht (megjithëse gjë që pritej), shumë devijatorë keqcitojnë ose keqinterpretojnë Kuranin dhe Hadithin, për të mbështetur orientimin e tyre të gabuar fetar. Dhe, po të mos kujtohen njerëzit se për çfarë janë porositur, atyre mund t'u duken bindëse disa nga gjërat që u thuhet, sepse, siç ka thënë Shekspiri: *“Djalli mund të citojë edhe Shkrimin e Shenjtë për qëllimet e tij”*<sup>3</sup>.

Të kthyerit rishtas në Islam, të cilët mund të mos e njohin dallimin midis një ortodoksi dhe një devijatori, midis pseudodijetarit të devijacionit dhe dijetarit ligjor të së vërtetës, duhet të jenë veçanërisht të kujdesshëm, në shqyrtimin dhe konfirmimin e atyre që u thuhet. Dhe më kryesorja, besimtarët duhet t'i luten Allahut që të marrë në mbrojtje zemrat, mendjet, trupat dhe shpirtrat e tyre nga devijimet e t'i udhëzojë në rrugën e drejtë të projektit të Tij. Në fund të fundit, kjo përbën lutjen e El-Fatihës, suresë së parë të Kuranit të Shenjtë, një lutje që ka një rëndësi e domethënie kaq të madhe, sa që Allahu i Lartmadhëruar, kërkon recitimin e saj në çdo rekat, sa herë që falemi. Dhe muslimanët e vërtetë duhet ta recitojnë këtë lutje me sinqeritet dhe bindje.

---

<sup>3</sup> Shakespeare, William. *The Merchant of Venice*. Liii.

## 1. a. Grupi i shpëtuar

Një hadith që citohet shpesh, konkludon me mësimin se, në fund të kohës, Islami do të ndahet në 73 grupe, nga të cilët 72 do të përfundojnë në zjarr. Kur e pyetën se cili do të ishte grupi që do të shpëtonte, Muhamedi (a.s.) u tha këto fjalë: “*Ata që ndjekin atë çfarë jam unë sot, si dhe shokët e mi*”.<sup>4</sup>

Ka muslimanë që thonë se ky hadith ka një dobësi në zinxhirin e transmetuesve të tij; të tjerë vërtetojnë se numri i plotë i transmetuesve e bën një hadith të sigurtë. Pavarësisht nga kjo, e vërteta është se feja islame nuk është ndarë ende në 73 grupe, por po shkon drejt asaj. Disa sekte të shiizmit, numri në rritje i sufive ekstremë, kulti i Ensarit, Ahmeditë (që njihen edhe si Kadiani’), Kombi Islam, Kuranitët dhe shumë të tjerë, paraqesin llojet e larmishme të devijimeve nga Islami (suni). Për më tepër, koncepti i grupit të shpëtuar, në përbërje të të cilit janë ata që i bashkohen asaj çfarë ndoqi Profeti (a.s.) dhe shokët e tij, u duket besimtarëve të konfirmuar, si një gjë që kuptohet vetvetiu.

Nga ana tjetër, ka dhe nga ata që propozojnë revizionimin e fesë islame, nisur nga nevoja e hamendësuar për modernizim të saj, duke marrë parasysh ndryshimet shoqërore dhe politike të 1400 vjetëve të fundit. Muslimanët kanë qenë historikisht nga popujt më përparimtarë të botës. Revolucioni industrial në Europë, u atribuohet gjerësisht dijeve dhe zbulimeve të marra nga bota muslimane, në një kohë kur aristokracia europiane i dërgonte fëmijët e saj për të studiuar në universitetet e Spanjës muslimane. Muslimanët shquheshin në linguistikë, në fizikën mekanike, optike dhe teorike, në kiminë organike dhe inorganike, në matematikë, bujqësi, mjekësi, gjeografi, astronomi etj. Shumë nga përparimet teknologjike, që kanë shtruar rrugën për një botë më të mirë, janë shpikur nga muslimanët, ndërkohë që vetë universitetet, kanë qenë pjesë e projektit musliman për një institucion të lartë edukimi.<sup>5</sup>

Prandaj, muslimanët nuk kanë pse druhen, kur duhet t’u adresohen temave që lidhen me ekzistencën e tyre në kohë, për çështje që nuk bien në kundërshtim me parimet fetare. Por, Allahu i Lartmadhëruar ka sjellë nëpërmjet Profetit të Tij të fundit, Muhamedit (a.s.), lajmin se Ai nuk do të pranonte asnjë ndryshim apo novacion fetar. Sipas një hadithi që vjen nga Aishja (r.a.), tregohet se Muhamedi (a.s.) ka thënë:

*“Kushdo që fut si risi në këto punë tonat [d.m.th në Islam] diçka që nuk ka të bëjë me to, ajo do t’i hidhet poshtë.”*<sup>6</sup>

Pra, ndërsa futja e gjërave të reja në çështjet jofetare, mund të sjellë vlera në pikëpamje praktike, tek vetë feja nuk ka fare vend për risi, sepse të gjitha risitë fetare të shpien në zjarrin e ferrit. Po të sjellim ndërmend faktin, që njerëzimi është krijuar vetëm për të

<sup>4</sup> Tirmidhiu (2641).

<sup>5</sup> Për informacion të mëtejshëm, lutemi të shihni librin e parë në këtë seri, *Urdhri i Parë dhe i Fundit*, kapitulli 3.C.8, dhe *Islami dhe Shkenca*, nga Shabir Ahmed, Enes Abdul Muntekim dhe Abdul-Sattar Siddik; botuar nga Islamic Cultural Workshop.

<sup>6</sup> Buhariu (2550), Muslimi (1718), Ebu Daudi (4606), Ahmedi (26075, 26372).

adhuruar Allahun dhe për të qenë në shërbim të Tij (Kur'an, 51:56: "**Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë**"), kjo formulë fiton kuptim të plotë, sepse nuk është puna që të bëhet më i lehtë e më zbavitës çdo aspekt i jetës, pa përjashtim, por më shumë, që të përmirësohen aspektet praktike të jetës, për të lehtësuar detyrën, për të cilën është krijuar njerëzimi, që është adhurimi i Allahut dhe shërbimi ndaj Tij.

Rrjedhimisht, është e admirueshme që ta bësh jetën më të lehtë, në kuptimin e ekzistencës në këtë botë, sepse kjo i përmirëson kushtet dhe e bën individin më të lirë në praktikat e adhurimit, si fizikisht, ashtu edhe mendërisht. Fizikisht, sepse rrethanat më të mira e bëjnë më të lehtë përmbushjen e ritualeve të adhurimit, dhe mendërisht, sepse kushtet më të mira, i japin një individ më shumë arsye për të qenë mirënjohës ndaj Zotit. Nga ana tjetër, të përiqesh që ta bësh fenë më të lehtë nëpërmjet lëshimeve në detyrimet fetare, është e qortueshme, sepse njeriu e mashtron Allahun kur vepron kështu, me detyra, për të cilat, ai ose ajo është krijuar në radhë të parë. Pra, telefoni është më i mirë se një pëllumb postier, por, ndërsa katër lutje në ditë janë më të lehta se pesë, kjo sigurisht që nuk është më e mirë, sepse çdo risi që bie në kundërshtim me Sheriatin (ligjin islam), të shmang nga feja, e kompromenton dhe e shkatërron praktikimin e saj.

Kjo na çon në një parim të përgjithshëm udhërrëfyes, që muslimani i ri do bënte mirë ta kujtonte: Çdo gjë që lidhet me adhurimin (në kuptimin e gjithçkaje, për të cilën adhuruesi shpreson shpërblim nga Allahu i Lartmadhëruar) është e ndaluar, me përjashtim të asaj që është urdhëruar, ndërkohë që lejohet çdo gjë nga punët e kësaj bote, me përjashtim të asaj që ndalohej. Këtë parim e kanë miratuar dijetarët, dhe muslimanët duhet që ta ngulisin në kujtesën e tyre, për faktin se ai e bën fenë të thjeshtë dhe e lehtëson procesin e vendim-marrjes. Dëshmitë që e mbështesin këtë parim, janë kaq të shumta, sa nuk mund të bëhet një listë e tyre në një libër si ky. Megjithatë, duhet thënë se Allahu i Lartmadhëruar e ka shpallur shprehimisht në një nga ajetet më të fundit të Kuranit: "**Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj**" (Kuran 5:3). Duke marrë parasysh këtë ajet, së bashku me kërkesën e shumëpërsëritur të Allahut për "t'iu bindur Allahut dhe të Dërguarit të Tij Muhamedit (a.s.)", muslimani duhet të respektojë hadithin që tregon se Muhamedi (a.s.) na ka mësuar:

1. "*Kushdo që fut si risi në këto punë tonat [d.m.th në fe], diçka që nuk ka të bëjë me to, ajo do t'i hidhet poshtë.*"<sup>7</sup>
2. "*Shmangeni atë që unë jua kam ndaluar dhe bëni sa më shumë nga ato që unë ju kam urdhëruar (të bëni)*"<sup>8</sup>.
3. "*Allahu i Lartësuar ka urdhëruar detyra fetare, prandaj mos i lini pas dore; Ai ka vendosur kufinj, prandaj mos i kapërceni; Ai i ka ndaluar ca gjëra, prandaj mos i dhunoni; Ai ka heshtur për ca gjëra, nga dhembshuria për ju, jo ngaqë ka harruar; prandaj mos kërkon përtej tyre!*"<sup>9</sup>

<sup>7</sup> Buhariu dhe Muslimi (1718).

<sup>8</sup> Buhariu (6858) dhe Muslimi (130).

Kjo do të thotë që nuk duhen eksploruar ato çështje, në të cilat Allahu, për shkak të dhembshurisë e mençurisë së Tij, nuk ka vënë rregulla, sepse rezultati mund të sillte më shumë humbje sesa përfitime. Lidhur me këtë, Allahu thotë në Kuranin e Shenjtë: "**O besimtarë! Mos pyesni për gjëra, që, sikur t'ju thuheshin haptazi, nuk do t'ju pëlqenin e, nëse do të pyesnit për to kur ju shpallet Kurani, do t'ju bëheshin të qarta. Allahu jua ka falur kërshërinë. Se Allahu është Falës dhe i Butë**". (Kuran 5:101). Pasi

Përveç kësaj, Allahu i Lartmadhëruar udhëzon:

1. ***Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj. Frikësojuni Allahut, sepse Allahu, dënon vërtet ashpër***. (Kuran 59:7)
2. ***“...dhe atyre që ndjekin të Dërguarin Tonë, Profetin që nuk di shkrim e lexim, të cilin ata do ta gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre, në Teurat dhe Ungjill. Ai do t'i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t'i ndalojë nga të këqijat...”*** (Kuran 7:157).
3. ***“Është Ai që për ju ka krijuar çdo gjë që ka në tokë”*** (Kuran 2:29).
4. ***“Thuaj: “Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Vet?”*** (Kuran 7:32).

Në këtë mënyrë, ky parim i përgjithshëm i ndalimit të çdo gjëje që lidhet me adhurimin, me përjashtim të asaj që është e udhëzuar, dhe për lejimin e gjithçkaje nga gjërat e kësaj bote, me përjashtim të asaj që është e ndaluar, jo vetëm që është i mbështetur plotësisht, por ushtron dhe një ndikim të fuqishëm. Meqënëse lidhet me temën e këtij diskutimi, ata që kërkojnë një rrugë më të lehtë në kuptimin e ekzistencës fizike dhe të gjërave të kësaj bote, nxiten që ta bëjnë një gjë të tillë, sikurse tregon një hadith autentik: *“Profeti (a.s.) nuk ka bërë kurrë ndonjë zgjedhje midis dy gjërave, pa zgjedhur më të lehtë, për sa kohë që kjo s'përbënte mëkat”*.<sup>10</sup> Ndërkaq, kushdo që kërkon novacione në çështjet e adhurimit duhet ndaluar dhe dënuar. Imam Maliku komenton:

“Ai që fut një risi për *umetin* diçka, në të cilën paraardhësit e devotshëm nuk kanë qenë, shpall në të vërtetë se Profeti Muhamed (a.s.) e ka tradhëtuar *umetin*, se Allahu i Gjithëfuqishëm ka thënë: ‘Sot, Unë e kam plotësuar fenë tuaj’. Ai që nuk ishte pjesë e fesë në atë kohë (të Muhamedit (a.s.) dhe të shokëve të tij), nuk është pjesë e fesë as sot”.<sup>11</sup>

Puna është se, ndërsa janë të mëdha mundësitë e përmirësimit të kushteve njerëzore në kuptimin e kësaj bote, në kuptimin e besimeve dhe të praktikave, ekziston një minimum tepër i vogël, që, nëse dhunohet, e bën të pavlerë pretendimin e çdo njeriu në raport me fenë. Kërkesat minimale të besimit islam, përcaktohen qartësisht. Lidhur me këtë, është për t'u përmendur shembulli që jep hadithi i mëposhtëm:

Një burrë nga Nexhdi, me flokët e pistë e të pakrehur, erdhi tek I Dërguari i Allahut dhe ne dëgjonim zërin e tij të lartë, por nuk kuptonim se çfarë thoshte, derisa na erdhi pranë dhe, atëherë, mësuam se ai po pyeste për Islamin. I Dërguari i Allahut i tha: “Ti duhet të falësh pesë namaze, në një ditë e një natë (24 orë)”.

---

ka përfunduar shpallja dhe feja është përsosur, janë bërë të njohura gjërat e këshilluara, që nuk lejojnë shtesa, dhe, po kështu, janë bërë të njohura edhe gjërat e ndaluara të ekzistencës në këtë botë. Diskutimi dhe hetimi i asaj, për të cilën Allahu ka zgjedhur të mos japë udhëzime, duhet shmangur.

<sup>9</sup> Daraqutni ( 42, 104)

<sup>10</sup> Buhariu (3367), Muslimi (2327), Imam Maliku (1603).

<sup>11</sup> Ibn Hazmi.

Burri e pyeti: “A duhet të fal ndonjë më shumë?” I Dërguari i Allahut iu përgjigj: “Jo. Por, nëse dëshiron të falësh namaze vullnetare, mund ta bësh”. Më pas, i Dërguari i Allahut i tha: “Duhet të agjërosh gjatë muajit të Ramazanit”. Burri pyeti: “A duhet të bëj ndonjë agjërim tjetër (më shumë)?” I Dërguari i Allahut iu përgjigj: “Jo. Veç nëse dëshiron të bësh agjëtime vullnetare, atëherë mund ta bësh”. I Dërguari i Allahut vazhdoi: “Duhet të paguash *zekatin*”. Burri pyeti: “Ka gjë tjetër, veç *zekatit*, që duhet të paguaj?” I Dërguari i Allahut iu përgjigj: “Jo, veç po të duash që të japësh vullnetarisht lëmoshë”. Pasi i dëgjoi këto fjalë, burri u largua, duke thënë: “Pasha Allahun! Unë nuk do të bëj as më shumë e as më pak se kaq”. I Dërguari i Allahut tha: “Nëse e thotë sinqerisht këtë fjalë, atëherë ai do të jetë i suksesshëm (pra, do t’i lejohet Parajsja)”.<sup>12</sup>

Ky hadith përmbledh në fakt, kufijtë minimalë të praktikës islame, duke treguar, në të njëjtën kohë, se respektimi i këtyre kufijve minimalë, shpie në shpërblimin e parajsës.

Kjo formulë duket e drejtë, sigurisht, sepse mijëra vjet me radhë njerëzimi ka përjetuar ditë për ditë formula të tilla. Për shembull, trupi kërkon një sasi minimale oksigjeni për të mbijetuar, si dhe një temperaturë minimale të brendshme të trupit. Po t’i mirëmbash këto minimume, njeriu mbijeton; në të kundërt, nëse i kapërcen sado pak ato, gjen vdekjen. Po kështu, automobili kërkon një sasi minimale karburanti për të shkuar nga një vend në një vend tjetër. Sikur edhe një pikë të ketë më pak se ky minimum i fundit, makina ndalon, edhe sikur të ketë mbetur fare pak rrugë për të shkuar aty ku duhet. Natyrisht, dikush mund të thotë: “E mori e mira! Parkoje makinën aty ku të la e bëje rrugën e mbetur me këmbë”. Por, ka gjëra që njeriu s’mund t’i heqë qafe kaq lehtë. Dështimi është njëri prej tyre. Në një provim, nota më e vogël se “10”, nuk është më “10”. Një kilogram me një gram më pak, nuk është më kilogram. Një hap prapa fituesit dhe... je në vendin e dytë. Një sekondë më shumë nën ujë dhe mbytesh. Një pikë më pak sesa minimumi i kërkuar, do të thotë të mos ia dalësh dot.

Mbaj oksigjenim dhe temperaturë trupi më të lartë se minimumi i kërkuar, dhe jo vetëm që do të ndihesh më mirë, po dhe rreziku nga ndonjë fatkeqësi do të jetë më i vogël. Mbaj më shumë karburant se ç’nevojitet, e do të kesh më shumë rezervë në rast nevoje. Njeriu mund të mbijetojë edhe vetëm me këto minimume fundore, po kjo është një jetë e rrezikuar, e parehatshme dhe, në kushte normale, një budallallëk i panevojshëm. Është mjaft më mirë të jetosh mirë, duke qenë brenda kufijve kritikë. Kështu ndodh dhe me fenë. Njerëzit që jetojnë në minimumet e skajshme të besimit e të praktikës, luhaten në gardhin e besimit të tyre, duke rrezikuar çdo ditë, pasojat e kalimit në anën e gabuar. Kurse, ata që e përsosin besimin, praktikën dhe adhurimin, jetojnë brenda zonave të gjera dhe të sigurta, që ofrojnë nivelet më të larta të devotshmërisë.

E, loja me kufijtë, është bërë e modës në sferat e sporteve ekstreme dhe të financave të larta, ku njeriu mund të fitojë famë ose pasuri, duke patur rrezik të dëmtohet fizikisht ose të pësojë dështim, zbatimimi i fesë në këtë mënyrë, vë në rrezik shpëtimin e një personi. Për çfarë, pikërisht? Për pak minuta të kursyera nga falja? Për ca kafshata më shumë, që i vidhen agjërimit? Për ca dollarë më shumë, të kursyer nga dhënia e mëshirës?! Të gjithë

<sup>12</sup> Buhariu (42) dhe Muslimi (11).

do t'i shikonin si një çmim tepër të vogël për shpëtimin, që ia vlen të sakrifikohet, padyshim, në të mirë të shtimit të sigurisë dhe të zgjerimit të zonave të paqes. E kjo, pa qenë nevoja që të kompromentohen elementet e tjera të ekzistencës njerëzore.

Nga ana tjetër, muslimanët bëjnë një jetë tepër të pastër, të ndershme, të shëndetshme dhe të këndshme. Për respekt të suksesit të standardit islam, fushat e politikës, të sjelljes personale, strukturës familjare dhe shoqërore, ekonomisë, ligjit penal e civil dhe shumë disiplina të tjera të ekzistencës njerëzore në botën islame, kanë gëzuar disa nga sukseset dhe jetëgjatësitë më të mëdha, falë parimeve të shëndosha fetare, mbi të cilat janë ngritur. Vetë feja islame praktikohet edhe sot e kësaj dite siç praktikohet në kohën e Profetit Muhamed (a.s.), gjë që e bën Islamin të vetmen fe Abrahamike, që praktikohet në ditët tona, me pastërtinë që kishte që në fillim. Nëse ka patur ndonjëherë ndonjë sukses rekord që dëshmon të vërtetën, është pikërisht ky. Për më tepër, Allahu ka përçuar premtimin se do ketë gjithmonë një grup njerëzish, që janë në udhën e drejtë, sepse një hadith autentik tregon se Muhamedi (a.s.) ka thënë: *“Gjithmonë do të ketë një grup nga umeti im, që do të qëndrojë haptazi në të vërtetën, deri në Ditën e Gjykimit”*.<sup>13</sup>

Le të përpiqemi të jemi prej tyre.

---

<sup>13</sup> Buhariu (3441), Muslimi (156), Ebu Daudi (4252), Tirmidhiu (2229).



## 2. SHTYLLAT

Me të hyrë në Islam, lind pyetja: “Çfarë duhet bërë tani?” Përgjigja më e shkurtër është: “Të kthehesh në shtëpi, të bësh një banjo dhe të fillosh të lutesh”.

Pasi futet një person në Islam, këshillohet që të kryejë një ritual pastrimi, që konsiston në larjen me ujë të të gjithë trupit. Zakonisht, ky ritual është privat dhe, njësoj si pagëzimi, është simbol i rilindjes me një shpirt të përtëritur. Feja islame mëson se, kur dikush bëhet musliman, falen të gjitha mëkatet e mëparshme të tij ose të saj. Ashtu siç pastrohet shpirti nga mëkatet, prej së vërtetës së pastër të dëshmisë së besimit, ashtu pastrohet simbolikisht edhe trupi, me pastërtinë e ujit.

Praktikat fizike që bëhen të detyrueshme për të kthyerin në Islam janë pesë, e para nga të cilat është rënia në *shehadet* (dëshmia e besimit), gjë që nënkupton se, krahas *shehadetit*, njeriu pranon në mënyrë të nënkuptuar, edhe bazat e besimit (besimi në Allahun, Engjëjt e Tij, Shkrimet e Shenjta, Profetët, Jetën pas vdekjes dhe Urdhrin Hyjnor). Katër detyrat që kërkohen në vazhdim janë: lutja pesë herë në ditë (në intervale të udhëzuara e në pajtim me rregullat islame të faljes dhe të pastrimit), agjërimi një herë në vit i muajit të Ramazanit, pagesa vjetore e *zekatit* (detyrimi për të varfërit), dhe pelegrinazhi në Mekë gjatë periudhës së *Haxhit*, një herë gjatë të gjithë jetës, nëse janë mundësitë fizike e financiare për një gjë të tillë. Dhe tani, duke sjellë ndërmend mësimin që pamë më sipër, pyetja e parë nuk duhet të jetë: “Mirë, po si t’i bëj këto gjëra?” Është më mirë që pyetja e parë të jetë: “Mirë, por të lutem, më thuaj në fillim, ku i ke gjetur këto udhëzime?”

Përgjigja është: Në Kuran dhe Sunet.

Lidhur me bazat e besimit, në Kur’an, thuhet:

**“... mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët ...”** (Kuran, 2:177).

Në lidhje me pesë shtyllat e Islamit:

**“ ... (mirësia është) e atij që fal namazin dhe e jep zeqatin...”** (Kuran 2:177);

**“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi...”** (Kuran 2:183-185), dhe

**“Kryeni haxhin dhe umren për hir të Allahut...”** (Kuran 2:196).

Këto besime ripohohen, ritheksohen dhe qartësohen, bashkarisht ose veç e veç në shumë pjesë të Kuranit të Shenjtë duke theksuar në mënyrë të përsëritur Njësimin, Gjithëfuqishmërinë dhe Urdhrin Hyjnor të Allahut. Në Sunet gjejmë atë që është bërë i njohur si Hadithi i Gabrielit, të cilin e tregon Omeri (shoku i Muhamedit (a.s.) dhe kalifi i dytë):

*Një ditë, ndërsa po rrinim ulur me të Dërguarin e Allahut, erdhi para nesh një njeri me një veshje shumë të bardhë dhe me flokë shumë të zinj. Nuk dukej të kishte ndonjë shenjë udhëtimi dhe asnjë prej nesh nuk e njihte. Ai [erdhi] u ul pranë Profetit (a.s.), i mbështeti gjunjët e tij pas gjunjëve të Profetit (a.s.), i vuri duart e tij mbi to e tha: “O Muhamed, më trego për Islamin”. I Dërguari i Allahut tha: “Islami është të dëshmosh se nuk ka asnjë tjetër, që ia vlen të adhurohet, përveç Allahut, dhe që Muhamedi(a.s.) është i Dërguari i Allahut, të kryhen faljet, të paguhet zekati, të agjërohet [në muajin] Ramazan dhe të bëhet pelegrinazh në Qabe, nëse i ke mjetet për ta bërë një gjë të tillë”. Ai tha: “Ke folur drejt!” Ne u çuditëm që ai bënte pyetje dhe pastaj thoshte se përgjigjja ishte e saktë. Ai tha: “Më fol për imanin (besimin)”. Ai [i Dërguari i Allahut] iu përgjigj: “Është të besosh te Allahu, Engjëjt e Tij, Librat e Tij, Profetët e Tij, Ditën e Gjykimit, dhe të besosh në Urdhrin Hyjnor, për të mirën e të keqen e tij, të dyja”. Ai tha: “Më fol për ihsanin (vetëdijen për Zotin)”. Ai [Profeti as] iu përgjigj: “Është që ta adhurosh Allahun sikur e ke përpara syve, sepse, edhe nëse s’e shikon, [dihet që] të shikon Ai”. Ai tha: “Më trego për momentin e Orës”. Ai [Profeti (as)] u përgjigj: “Ai që pyetet nuk di më shumë sesa ai që pyet”. Ai tha: “Më fol për shenjat e saj”. Ai tha: “Vajza skllave do të lindë zonjën e saj e ju do t’i shihni barinj të këmbëzbathur, të veshur keq e varfanjakë, tek konkurojnë në ngritjen e ndërtesave të larta”. Pas kësaj, ai u largua. Unë qëndrova edhe për pak. Pastaj, Profeti (a.s.) më pyeti: “O Omer, e di se kush ishte ai që bënte pyetje?” I thashë: “Allahu dhe i Dërguari i Tij, e dinë më mirë!”. Ai tha: “Ishte engjëlli Gabriel, që kishte ardhur për t’ju mësuar fenë tuaj”.<sup>14</sup>*

*“Islami është ngritur mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi (a.s.) është i Dërguari i Tij, kryerja e faljeve, pagimi i zekatit, kryerja e pelegrinazhit në Qabe dhe agjërimi i Ramazanit.”<sup>15</sup>*

Dhe tani që kemi vërtetuar autoritetin e mësimdhënies, mund të vazhdojmë.

Ritualet e faljeve kërkojnë kohë të mësohen dhe një i kthyer në Islam, arrin të kuptojë që Allahu i fal mangësitë e fillimit për sa kohë që ai përpiqet të mësojë dhe të përmirësohet. Megjithatë, faljet duhen bërë në kohën e tyre dhe i kthyeri në Islam, ka si detyrë ta mësojë e ta përsosë faljen sa më shpejt të jetë e mundur e në pajtim me mënyrën dhe kushtet e lutjeve sipas Sheriatit.

Në një moment të caktuar të vitit të parë, i kthyeri në Islam do të ndeshet me agjërimin e muajit Ramazan si dhe me sezonin e *haxhit* (pelegrinazhit) në Mekë, që pason agjërimin e Ramazanit me dy muaj hënorë. Të dyja këto shtylla demonstrojnë praktikitetin e fesë islame, sepse, ndonëse agjërimi për herë të parë, mund të jetë përvojë e vështirë për disa njerëz, i kthyeri në fe mund të gjejë ngushëllim, kur di që paaftësia për të agjëruar mund të kompensohet. Është për këtë arsye, që agjërimi nuk u kërkohet atyre që e dinë se janë të paaftë, për shkak të vështirësive të tilla, si shëndeti i dobët apo mosha e thyer. Në të

<sup>14</sup> Muslimi (8).

<sup>15</sup> Buhariu (8), Muslimi (16).

njëjtën mënyrë, *haxhi* është detyrë për muslimanët që e kanë mundësinë (si fizike ashtu edhe financiare), kurse ata që nuk e kanë mundësinë, janë të përligjur, sa kohë që këtë ua detyrojnë rrethanat. Megjithatë, rëndësia e këtyre shtyllave të fesë, nuk duhet nënvlerësuar. Njeriu duhet ta pranojë këtë zbutje rregullash, vetëm nëse është vërtet i paaftë për të kryer ritualin e kërkuar. Për shembull, Omeri r.a. e theksonte rëndësinë e haxhit me këto fjalë: “*Muslimani që ka mundësi ta kryejë haxhin, por nuk e bën, e që vdes në këtë gjendje, le të vdesë si çifut apo kristian*”.<sup>16</sup>

Pagesa e *zekatit*, detyrimi për të varfërit, është e fundit nga të pesë shtyllat e Islamit që i kthyeri në të, duhet të kryejë, sepse *zekati* paguhet një herë në vit. Ndoshta, një nga shtyllat më pak të kuptueshme është *zekati* e cila nuk është taksë e dhjetë, sepse s’është një përqindje mbi të ardhurat. Ka njerëz që kanë nevojë për të gjitha të ardhurat që kanë për të jetuar, e kështu nuk mund të japin gjë. Prandaj *zekati* nuk është përqindje e të ardhurave, por më shumë është përqindje e tepricës së pasurisë, gjë që do të thotë se, muslimanët urdhërohen të paguajnë një detyrim të vogël për të varfërit (2.5 % ose 5 %, në varësi të kategorisë) nga pasuria që kanë, mbi nevojat e një periudhe njëvjeçare. Pra, nëse dikush ka një milion dollarë gjatë njëmbëdhjetë muajve, dhe i humbet të gjitha në të dymbëdhjetin, nuk e ka detyrim *zekatin*. Në mënyrë të ngjashme, nëse dikush e nis vitin me një shtëpi, një makinë dhe një rrogë, bile, për më tepër, me një rrogë të mirë, por e mbaron vitin me të njëjtën shtëpi, makinë e rrogë, pa kursyer asgjë përtej nevojave të vitit të mëparshëm, nuk e ka detyrim *zekatin*. *Zekati* është i detyrueshëm vetëm për ato elemente të pasurisë, që janë më shumë se ç’ka nevojë njeriu dhe të cilat, ai i zotëron gjatë një viti të plotë (për shembull, para, flori, të korra, mallra tregtare që mendohet të shiten, bagëti, etj.)<sup>17</sup>

Diskutimi i mësipërm, paraqet thjesht një hyrje fare të shkurtër sepse secila nga të pesë shtyllat e Islamit mund të diskutohet në libra të tëra, që i kushtohen vetëm këtij subjekti, dhe në fakt janë shkruar plot të tillë. Qëllimi i këtij libri nuk është të dublohet informacioni që është i disponueshëm tashmë, por vetëm të sugjerohet rruga më e mirë, që të kthyerit në Islam, të jenë në gjendje që të integrojnë praktikën e fesë në jetët e tyre. Lidhur me këtë temë, gjëja më e lehtë do të ishte të këshillohej një ose më shumë libra për subjektin e shtyllave të Islamit dhe, pastaj të kalohet në çështjen tjetër. Por, jo kaq shpejt. Këtu ka një vështirësi që shfaqet menjëherë, e që duhet të zgjidhet, përpara se të trajtojmë një çështje tjetër.

Dhe kjo është tepër e rëndësishme. Problemi është ky: Nisur nga themelet e qarta e të thjeshta të Islamit, nga fjala e Allahut në Kuranin e Shenjtë e shembulli i të Dërguarit, Muhamedit (a.s.), siç është regjistruar në Sunet (hadith), njeriu mund të presë një përgjigje të qartë e të besueshme, për çdo pyetje të thjeshtë e të sinqertë. Në 80-90% të rasteve, kjo shpresë e arsyeshme përmbushet. Por, jo përherë. 10-12% e çështjeve fetare, nuk arrijnë dot në pajtim unanim midis dijetarëve. Kështu, ka njerëz që e shikojnë si

<sup>16</sup> Beihakui (8444).

<sup>17</sup> Një sasi e caktuar e pasurisë monetare është e përjashtuar nga *zekati*. Kjo sasi është e barabartë me vlerën në treg të 85 gr flori ose 595 gr argjend. *Zekati* është i detyrueshëm mbi pasurinë monetare, që është mbi këtë sasi, nëse zotërohet për një vit të plotë.

problem, mungesën e konsensusit akademik, ndonëse në fakt, ajo duhet toleruar e marrë parasysht. Le të shpjegohemi.

## 2. a. Dallimet

Si musliman i ri, e vrisja mendjen disi i hutuar lidhur me këtë problem të mospajtimit akademik. U mundova për afro dy vjet me këtë çështje, derisa një ditë, takova një vëlla maroken në rrugët e Kembrixhit, në Angli, duke shkuar në këmbë në faljen e së premtes. Hymë në bisedë për këtë pikë, e ai më tregoi një ndërtesë dhe më tha pak a shumë, këto fjalë: “E shikon atë ndërtesë? Unë jam inxhinier ndërtimi dhe mund të të them se, të gjitha ndërtesat projektohen në mënyrë që të kenë një shkallë të caktuar fleksibiliteti. Ato duhet të përkulen kur fryn erë, kur ndodhin lëkundje sizmike apo kur ka ndryshime të temperaturës. Në të kundërt, ato do të ishin të brishta e do pësonin çarje, prishje strukturore e madje mund të shemben edhe nga një lëkundje krejt e vogël. Në fe duhet të ketë fleksibilitet e ky fleksibilitet në Islam, duhet gjetur tek dallimet akademike”.

Ky vëlla më ka ndihmuar në mënyrë të jashtëzakonshme që të nis e të kuptoj mençurinë Hyjnore që qëndron pas kësaj çështjeje. Me kohë, arrita të kuptoj disa gjëra: që dijetarët e Islamit bien dakord në të gjitha problemet e rëndësishme e që mospajtimet e tyre, lidhen vetëm me çështje të vogla të dorës së dytë. Për shembull, dijetarët pajtohen me kërkesën e pesë faljeve në ditë dhe me kushtet e faljes, të tilla si rituali i pastrimit të personit, vendi dhe veshja, me pjesën më të madhe të [përbërësve të] vetë faljes e me kushtet që e bëjnë atë të vlefshme apo të pavlefshme, etj. Ndërkaq, ekzistojnë ndryshime akademike për disa çështje të vogla e të dorës së dytë, të tilla si: Ku duhet t'i mbajnë duart muslimanët gjatë faljes, si duhet drejtuar gishti kur rrinë në sexhde, nëse *bismilahu* (vargu i parë i Fatihasë, që më së shumti përkthehet “Me emër të Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëplotit”), duhet thënë në heshtje apo me zë etj. Këto mospajttime duhet të pranohen e tolerohen në opinion, sepse këto dallime nuk mundën t'i zgjidhnin as dijetarët e mëdhenj të së kaluarës, pavarësisht nivelit të tyre në dije e urtësi që eklipson atë të dijetarëve të kohëve tona.

Momenti kryesor i *Fikhut* në epokën tonë përqendrohet në rregullimet ligjore të gjërave të reja, që kanë shkaktuar ndryshimet shoqërore, politike dhe teknologjike. Përpjekjet për të korrigjuar mospajtimet mijëvjeçare, kanë qenë të pakta, por dhe ato, zakonisht rezultojnë të pafrytshme dhe irrituese. Përveç kësaj, shpesh, këto përpjekje i ndajnë muslimanët në kampe të veçanta, që grinden mes tyre për gjëra të vogla e pak a shumë pa rëndësi, po të kemi parasysht tablonë tërësore të gjërave. E vetmja gjë, për të cilën muslimanët nuk kanë nevojë, është një arsye më shumë për ndarje.

Fatkeqësisht, muslimanët e përqendrojnë vëmendjen më shumë në ato pak detaje, në të cilat kanë dallime, sesa në bazën e gjerë të fesë, për të cilën pajtohen me njëri-tjetrin, e që është edhe problemi më i rëndësishëm i jetës dhe i fesë. Është një e vërtetë e hidhur që, në kohët kur muslimanët vuajnë për bukën e gojës, dhunohen, torturohen dhe vriten, në Palestinë, Bosnjë, Afganistan, Çeçeni, Kashmir, Birmani etj, në Amerikë e Angli

diskutohet nëse gjatë faljes duhet të radhiten sipas nyjeve, thembrave apo majave të gishtave të mëdhenj të këmbëve, etj.

Ndoshta, ky përqendrim mbi çështje të vogla, është vetëm pjesë e tekave të natyrës njerëzore, por edhe nëse është kështu, përsëri mund të jetë një vegël e shejtanit, për t'i larguar muslimanët nga problemet më të rëndësishme për jetën dhe fenën e tyre. Sido që të jetë e vërteta, pasoja është shkatërrimtare dhe çoroditëse për të kthyerit e sinqertë në Islam. Nga njëra anë, ata e përqafojnë Islamin, duke kërkuar botën e paqes shpirtërore, nëpërmjet sigurisë fetare; nga ana tjetër, i gjejnë muslimanët duke polemizuar, e ndonjëherë, edhe duke luftuar, për dallime të vogla e të dorës së dytë, që është më mirë t'i tolerojnë e t'i lënë mënjane, për t'iu gëzuar solidaritetit të fesë së vërtetë.

Pas kësaj, njeriu mendon natyrshëm, se duhet të ketë vetëm një përgjigje të saktë për çdo pyetje, dhe përpiqet të ndreqë çdo dallim që ekziston. Ndonjëherë kjo është e mundur, ndonjëherë jo; por kjo gjë është fare e panevojshme në 100% të rasteve, sepse thelbi i fesë islame është i qartë dhe i miratuar me konsensusin e dijetarëve suni, kurse mospajtimet për elementet e vogla e dytësore, për ligjen lehtësisht mbi bazën e mësimin islam, që thotë se veprimet gjykohen sipas qëllimit të tyre (Profeti (a.s.) ka thënë: *“Veprimet bëhen me qëllim, prandaj çdo njeri do të marrë atë që ka pasur qëllim”*<sup>18</sup>).

Puna është se procesi i zgjidhjes së problemeve islame nuk përfundon gjithnjë me gjykime të sakta dhe uniforme, por kjo s'përbën ndonjë problem. Askush nuk është i përsosur. Kështu, edhe dijetarët kanë mendimet e tyre, e madje ndonjëherë, bëjnë edhe gabime. Feja islame e merr në konsideratë nivelin e njeriut që gabon. Është në dorë të Allahut të Lartmadhëruar që t'i falë gabimet e dijetarëve, ndër kohë që gabimet e njerëzve të zakonshëm, lidhur me gjykimet ligjore, kërkojnë ndëshkim. Çështja nuk përfundon me faktin nëse një gjykim i caktuar ligjor, është i drejtë apo i gabuar, por nëse është i drejtë vetë procesi i dhënies së këtij gjykimi. Dijetarët janë të detyruar nga vetë dhurata e diturisë së tyre, që ta zhvillojnë gjykimin, në pajtim me nivelin e specializimit të tyre, ndërsa të tjerët janë të detyruar që t'i respektojnë ata. Nga ana tjetër, laikët meritojnë të qortohen, kur ndërmarrin gjykime, që nuk i përshtaten nivelit të përgatitjes së tyre. Për perëndimorët, që vënë në diskutim të gjitha nivelet e autoriteteve, kjo formulë mund të jetë e papërshtatshme dhe e ngatërruar, por ja që kjo është tradita islame në lidhje me dijetarët.

Ajo cka u tha më lart, nuk nënkupton se individit nuk mund ose nuk duhet të kërkojë dëshmi për të mbështetur gjykimin e ndonjë dijetari të veçantë. Jo. Këto kërkesa zakonisht priten mirë, sa kohë që kërkuesi pyet në kuadrin e procesit të kërkimit të dijes, e jo në përpjekje për të sfiduar apo kundërshtuar dijetarin. Sjellja e karakterit ballafaques, mund të pranohet, vetëm nga ata që kanë një pozicion të ngjashëm akademik, por në përgjithësi, ajo konsiderohet si e papërshtatshme nga ana e kërkuesit. Pra, hetimi i autoritetit është i pranueshëm nëse bëhet me modesti dhe mirësjellje, sepse, siç u tha më lart, veprimet gjykohen sipas qëllimit.

---

<sup>18</sup> Buhariu (1), Muslimi (1907).

Me kalimin e kohës dhe edukimin e mëtejshëm, muslimani i ri nis që t'i vlerësojë standartet strikte të dijetarisë së kualifikuar islame që tregojnë se mund të shkurajojnë këdo që del me standarde akademike pak a shumë të buta nga institucionet edukative perëndimore. Sapo një i kthyer në Islam apo student i fesë, arrin të bëjë dallimin midis dijetarëve dhe njerëzve të tjerë në Islam, ai fillon t'i bindet autoritetit dhe gjykimeve të tyre. Nga ana tjetër, paqja, siguria dhe lehtësia e zbatimit të një praktike të tillë, nuk është e huaj për të kthyerit në fe shumë nga të cilët përpiqen të rizbulojnë ndijimin e paqes, që shoqëron fillimisht kthimin në Islam. Para të gjithë atyre që kanë përqafuar thjeshtësinë e një rruge të tillë, shfaqet pa vështirësi paqja e të jetuarit në fenë e së vërtetës, siguria e ndjekjes së vendimeve të dijetarëve dhe lehtësia e zbatimit të fesë, të gjitha të bazuara në një dijetari të kualifikuar. Në këtë strukturë, dijetarët kanë përgjegjësinë e vendimeve të tyre ndërsa studentët dhe laikët, kanë përgjegjësinë e përmbajtjes ndaj mësimave të dijetarëve dhe gjithkush kthehet i lumtur në shtëpi, i plotësuar dhe i qetë për shkak se kanë proceduar saktësisht. Kurse ata që janë të prirur për përpjekje që synojnë rishpikjen e jurisprudencës islame, zakonisht e gjejnë veten të mbërthyer pas argumentimit dhe konfliktit, të shkëputur nga paqja dhe qetësia e rrugës së drejtë, për shkak të përpjekjes së kotë për ta ripercaktuar *fikhun* mbi bazën e një dijetarie të pakualifikuar e të papjekur.

Por, ç'ndodh nëse bëhet gabim? Kjo pyetje i turbullon zemrat dhe mendjet e besimtarëve, sepse ata shpesh luftojnë për çështje pak të rëndësishme, nga zelli që kanë për përsosmëri në besimin dhe adhurimin e tyre. Nëse secili bën atë që i takon, atëherë nuk ka vend për qortime. Islami mëson se Allahu i njeh dijetarit shpërblimin e një veprë të mirë për angazhimin e tij ose të saj në dhënien e gjykimit, si dhe shpërblimin me një punë tjetër të mirë, nëse gjykimi i dhënë, është i drejtë. Pra, dijetarët marrin shpërblimin e dy punëve të mira, nëse kanë qenë të drejtë në gjykim, dhe të një pune të mirë, nëse nuk kanë qëlluar në shenjë, e kjo, vetëm sepse thjesht kanë përmbushur përgjegjësinë e afirmimit të dijes, për të cilën janë besuar. Laikët kanë një tjetër nivel përgjegjësie dhe shpërblehen për plotësimin e detyrës së tyre për të pasuar dijetarët. Në këmbim të kësaj, laikët nuk mund të mbajnë përgjegjësi për përfshirje në gabimet e pakuptueshme që mund të bëjnë dijetarët, sepse nuk mendohet që laikët të kenë mjete diturie, që do t'u jepnin mundësi të dinin më mirë. Pra, kur dijetarët e përcaktojnë jurisprudencën islame në pajtim me aftësitë e tyre (pa bërë shirk në detyrat e tyre dhe pa tejkaluar limitet e dijetarisë së tyre), dhe kur laikët e pasojnë *fikhun*, e formuluar nga dijetarët e respektuar (duke pasuar opinionin e atyre dijetarëve që ata i shohin si më të ditur e më të besueshëm, e pa u tallur me procesin, duke kërkuar ato mendime që u pëlqejnë, kudo që gjejnë të tilla), të gjithë pjesëmarrësit në proces janë korrektë dhe asnjëri prej tyre nuk ka pse të qortohet kështu që të gjithë mund të ishin të lumtur dhe në paqe me familjen e tyre e me Allahun.

Por, pse nuk ecën puna atëherë?

Thjesht, vetëm për faktin se ka zell të tepruar fetar, mospajtim e intolerancë, kur bëhet fjalë për dallimet në *fikh*. Ngurtësia dhe mungesa e elasticitetit, mund të jetë gjithë e mirë kur flitet për çështjet e *akides* (doktrinës, besimit), të cilat lejojnë pak ose aspak hapësirë për ndryshim, ndërkohë që dallimet në *fikh*, janë pranuar, toleruar e respektuar qysh në kohën e dijetarëve të hershëm. Muslimanët që nuk i respektojnë këto dallime, luftojnë

ndaj një orteku prej një mijë vitesh bashkëjetese paqësore mes shkollave të dijes, pavarësisht nga dallimet në *fikh*, që kundërshtojnë rregullin. Këta muslimanë janë përçarës, poterexhinj, intolerantë e të ngurtë dhe i gjen zakonisht, në qendër të çdo debati, duke shprehur opinionet më të forta, me zërat më të lartë, me dijet më të pakta dhe me sjelljet më vulgare. Për fat të keq, ata janë kaq të përhapur në Amerike, në Angli dhe në Europën Perëndimore, saqë janë të pranishëm pothuajse në çdo xhami të botës perëndimore. Këta individë duhen të mbahen nën vëzhgim, të këshillohen dhe, nëse duhet, edhe të shmangen. Herë-herë, ata qetësohen e zbuten me kalimin e kohës, herë të tjera jo. Kjo është një betejë shumë e vështirë, që shpesh ka dështuar e po aq herë është humbur. Por, ndoshta individë të këtillë do t'i vinin veshin këshillës më të mirë, sepse në Kuranin e shenjtë, shërbëtori i ndershëm *Llukman*, e këshillon të birin e vet me këto fjalë:

***“O djali im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve! Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët! Ec me kujdes e i përmbajtur dhe fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!”*** (Kuran 31:17-19)

Nga ana jetër, një nga betejat e të kthyerve në Islam, është ruajtja e paqes së brendshme, e cila mund të luhatet, kur mendimet konfliktuale të dijetarëve, shpëputen nga mësimi i thelbit të besimit e praktikës. Megjithatë, Islami është fe e rrugës së mesme dhe, kur dikush kërkon me sinqeritet, kjo rrugë gjendet pothuajse gjithmonë. Rruga e mesme është rruga e maturisë, për të cilën brezat e mëparshëm kanë nxjerrë mësimin “maturi në të gjitha gjërat”. Vështirë se mund të gjendet një proverb perëndimor më i përshtatshëm se ky për sa i përket praktikimit të fesë islame. Nëse të kthyerit në muslimanë, kërkojnë të jetojnë në rrugën e drejtë e të mesme të Islamit, unë do t'u këshilloja thjesht të kërkojnë e të gjejnë muslimanët e qetë dhe modestë, që duket se e kanë praktikuar fenë e tyre, duke shmangur me mirësjellje anëtarët poterexhinj e përçarës të komunitetit musliman. Njeriu nuk mund të shkojë gabimisht shumë larg, po të kujtojë fjalët hyrëse të *Desiderata-s*:

“Ec gjakftohtë përmes zhurmës e ngutjes,  
dhe kujto se ç'paqe mund të gjesh në qetësi.  
Mbah marrëdhënie të mira me të gjithë njerëzit  
sa më shumë që të jetë e mundur, pa u lodhur.  
Thuaje të vërtetën tënde, qetësisht dhe qartë  
e dëgjoje tjetrin, qoftë dhe teveqel a i paditur,  
se edhe ata e kanë një histori të tyre.  
Largohu prej njerëzve poterexhinj e agresivë,  
sepse ata ta turbullojnë shpirtin ...”

Përveç kësaj, dijetarët i ushqejnë dhe i ngrohin shpirtat. Ata duhen gjetur në rrethet e dijes, të sjelljeve të mira e të vullnetit të mirë. Paqja dhe siguria duhen gjetur në shoqërinë dhe mësimet e tyre.

## 2. b. Dijetarët dhe Fikhu (Jurisprudenca islame)

Siç e thamë më lart, të gjitha grupet që pretendojnë identitetin islam, qofshin ato të drejta, ose jo, pohojnë se ndjekin Kuranin dhe Sunetin, ashtu siç interpretohen nga “dijetarët” (*ulematë*). Fjala “*ulema*” tingëllon kaq ekzotike dhe autoritative, sa që njeriu mund të gënjejë lehtë nga komente të tilla si: “ulematë e Islamit mësojnë se ...”, apo “ulematë e Islamit thonë që ...”. Por, ç’janë në të vërtetë këta “ulema” misteriozë, që thonë të gjithë se i pasojnë? Kuptohet vetvetiu se, grupe të ndryshme kanë opinione po aq të ndryshme se cilit grup të dijetarëve apo pseudodijetarëve, i përgjigjet koncepti i tyre i “*ulemave*”. Por, si mundet atëherë, që një i kthyer në fe, të dijë se cilët janë dijetarët e vërtetë dhe të kuptojë çështjet që i dallojnë ata nga njëri-tjetri?

Si fillim, njeriu duhet të kuptojë që dallimet akademike në lidhje me elementet dytësore të *fikhut* islamik, duhen respektuar e toleruar. Nga ana tjetër, duhen mbështetur e të mos debatohen çështjet, për të cilat është arritur *ixhmaja* (konsensusi) midis dijetarëve. Kështu, mund të ketë hapësirë për një hetim e diskutim të sjellshëm midis studentëve të dijes dhe dijetarëve, për çështjet e dallimeve akademike, po ka fare pak ose aspak vend për debatim, lidhur me pikat, për të cilat është marrë *ixhmaja* e dijetarëve, qoftë midis imamëve të katër medhhebeve (shkollave të mendimit)<sup>19</sup> ose dijetarëve të respektuar, të periudhave të mëvonshme të historisë islame. Për më tepër, ata që debatojnë çështjet e *fikhut* pa dije apo përgatitje të mjaftueshme, duhen shmangur me çdo kusht, sepse kjo është një çështje që u përket vetëm dijetarëve të kualifikuar. Në Kuran thuhet:

***“Kur atyre u vjen ndonjë lajm i rëndësishëm që ka të bëjë me sigurinë ose frikën, ata e përhapin (pa e vërtetuar mirë). Por, në qoftë se këtë lajm do t’ia përcillnin (për shqyrtim) të Dërguarit dhe parisë, hulumtuesit do ta merrnin vesh prej tyre (se çfarë lajmi duhet përhapur e çfarë jo). Sikur të mos ishte mirësia e Allahut dhe mëshira e Tij, ju të gjithë do të ndiqnit djallin, përveç një numri të vogël”.*** (Kuran, 4: 83)

Pikë së pari, muslimanët duhet të ruhen nga mendimet e njerëzve të pakualifikuar, keqduhëzimi i të cilëve, mund t’i përqaset atij të *shejtanit*. Së dyti, ata duhet të pushojnë së luftuari për çështje të vogla të dorës së dytë, për të cilat nuk është arritur marrëveshje gjatë 1400 vjetëve, dhe që nuk janë edhe aq të rëndësishme. Për shembull, çështjet e *akides* (doktrinës), janë të një rëndësie shumë më të madhe, sesa të diskutosh e të vrasësh mendjen se ku i mban njeriu këmbët e duart gjatë faljes. Po kështu, muslimanët duhet t’u japin fund sfidave për çështje, për të cilat, dijetarët përgjatë 1400 vjetëve kanë rënë në marrëveshje unanime, qofshin të mëdha apo të vogla, sepse, përveç rastit kur zotërohet dija e nevojshme për të rivalizuar dijetarët e mëdhenj të së kaluarës, këto probleme janë të vendosura dhe të mbyllura.

Muslimanët duhet të pranojnë se ekzistojnë aspekte praktike të afrimit drejt dijeve islame. I sapokthyeri në Islam ka nevojë të drejtohet për në udhën e drejtë sa më shpejt që të jetë

---

<sup>19</sup> Shumica e muslimanëve në gjithë botën ndjekin njërin nga katër medhhebet (që njihen si medhhebet Shafi, Hanefi, Hambeli dhe Maliki, sipas emrave të imamëve, interpretimet e të cilëve, formuan bazën e secilit medhheb).



e mundur, pastaj të rehatohet në të, dhe, ajo që është dhe më e rëndësishme, të mos shkurajohet nga feja për shkak të zënkave të pandërprera e kokëforta. Ai preket nga sindroma e zakonshme e kthesës së fortë fetare, që shkaktohet nga konfuzioni i ndeshjes me pikëpamje delikate e konfliktuale të llojeve nga më të ndryshmet. Lëvizjet radikale nga një ekstrem i mendimit në një tjetër, që kryqëzohen shpesh me rrugën e drejtë e të mesme të maturisë, si dhe luhatjet e pakontrolluara dhe zakonisht pa një drejtim, janë të frikshme e çoroditëse, e kjo jo vetëm për të sapokthyerit në Islam.

Ndërsa të sapokthyerit mund të vuajnë fillimisht konfuzionin dhe pasigurinë që sjell humbja e shpresës për të gjetur një udhërrëfim të kënaqshëm e përfundimtar, ata që ndodhen pranë tyre, dhe pikërisht miqtë dhe familiarët e interesuar, të cilët muslimani i ri shpreson t'i arrijë nëpërmjet *daves* islame (ftesës), mund të ndikohen negativisht kur bëhen dëshmitarë të luhatjeve të forta e të pavendosura në mendime e në praktikë. Më në fund, i sapokthyeri mund t'i amortizojë luhatje të tilla, por ka shumë që nuk mund ta bëjnë këtë gjë dhe disa prej tyre, të lodhur, si të thuash, nga paaftësia për ta mbajtur drejtimin siç duhet, e braktisin Islamin plotësisht.

Zakonisht *akideja* nuk është shkaku kryesor i konfuzionit të të sapokthyerit, sepse është pikërisht korrektësia e saj, që i ofron arsytjen e parë të kthimit. Shumica e të sapokthyerve futen në Islam ngaqë kanë konstatuar se mësimet e thjeshta të *akides* dhe *tevhidit* në Kuran, pajtohen me modelin e besimit që ka lindur së bashku me ta. Vetëm më vonë, dallimet e *akides* mund të bëhen objekt studimi.

Duket se subjekti kryesor i ngatërresave janë dallimet në *fikh*. I sapokthyeri e mban mend mirë përvojën e faljes për herë të parë, ku e patën porositur të rreshtohet sipas gishtave të mëdhenj të këmbëve, të vendoste duart kështu apo ashtu, të bënte me gishtat këtë apo atë, ndërkohë që rri ulur, të ulej në këtë apo atë mënyrë, etj. Ditën tjetër, ndonjë vëlla apo motër që niset nga qëllime dashamirëse, e shikon të sapokthyerin dhe ndihet i gatshëm ta udhëzojë që të radhitet sipas thembrave të këmbëve, t'i mbajë duart në vend tjetër, ta përthyejë gishtin në vend që ta drejtojë, etj. Pas ca raundeve me vëllezër e motra dashamirëse, që e hedhin të sapokthyerin përtej mureve të ndryshëm të *fikheve* të vegjël, por konfliktuale, disa të kthyer velen e dorëzohen, duke i lënë motrat e vëllezërit dashamirës, por çorientues, tek mendohen se çfarë gabimi kanë bërë, ndërkohë që, në fakt, ata thjesht e kanë bërë lëshim të kthyerin dhe e kanë dëbuar nga xhamia, përmes një mbingarkese informacionesh konfliktuale.

Pra, cila është rruga më e sigurtë e më e mirë, me anë të së cilës muslimanët e rinj, mund të mësojnë dhe praktikojnë fenë e tyre? Përgjigjja ndaj kësaj pyetjeje ndryshon nga një "dijetar" tek një tjetër, ndonëse fatmirësisht, ofrohen vetëm disa mundësi. Si fillim, shumë dijetarë dhe imamë tentojnë të rekomandojnë librat më modernë të jurisprudencës islame, të tillë si *Fik us-Sunneh*, nga Sejid Sabik, traktate më të vogla nga Nasruddin el-Albani dhe të tjerë, dhe studimi vetiak i koleksioneve të hadithit e tefsirit. Të tjerë i adresojnë muslimanët e rinj te librat e ndonjërit nga katër medhhebet.

Sigurisht, të gjithë librat e rekomanduar kanë përkrahësit e kundërshtarët e tyre dhe çdo person duhet të hetojë vetëm mendimet e ndryshme, për të vendosur se cilin do të ndjekë. Kaq mjafton, si fillim. Nuk është për t'u habitur që shumë nga ata që fillimisht i janë

futur një udhe të studimit, në fund kalojnë në një tjetër rrugë. Ky proces nuk është fare i padobishëm, për faktin se njerëzit mund ta zgjedhin më mirë drejtimin që do të marrin, pasi t'i kenë peshuar të gjitha opsionet. Megjithatë, një pjesë e mirë e pavendosmërisë dhe luhatjeve fillestare mes shkollave të mendimit, vjen nga keqkuptimi i roleve të medhhebeve dhe nga ajo që njihet, në terma moderne, si lëvizja selefije. Shumë njerëz i shohin këto të dy entitete në konflikt me njëra-tjetrën e në pamje të jashtme, kjo mund të duket e vërtetë. Megjithatë, po të hetohet, muslimanët arrijnë zakonisht të vlerësojnë se këto shkolla të mendimit, janë në fakt plotësuese të njëra-tjetrës, sepse fillimisht medhhebet kanë dalë si shkolla të *fikhut*, ndërsa lëvizja selefije synon një reformim të Islamit. Reformat selefije fokusohen në radhë të parë në korrigjimin e atyre gabimeve që janë shtuar aq shumë sa kanë korrupsuar *umetin* musliman në përgjithësi, dhe sistemin e medhhebeve në veçanti. Ndër problemet më të mëdha, përmendim:

1. Gabimet në *akide*, që u institucionalizuan në medhhebe, nëpërmjet përshtatjes së vajtueshme të *akideve* esharite dhe maturidite;
2. Praktika e sufizmit, e cila jo vetëm që u fanatizua dhe u ekstremizua, por siç duket u lidh ngushtësisht edhe me medhhebet e periudhës pas Ebu Hamid Muhamed el-Gazaliut (1058-1111 e.r.);
3. Refuzimi virtual i dijetarëve të medhhebeve për të ndryshuar *fikhun* e medhhebit përkatës, kur paraqiten me dëshmi hadithesh konfliktuale, pavarësisht detyrimit fetar për të vepruar kështu, sa herë që gjenden hadithe me dëshmi të vlefshme;<sup>20</sup>
4. *Teklidi* ose pasimi i verbër.
5. Infiltrimi i zakoneve jofetare (duke përfshirë ato që rigjallërohen që nga periudha e padijes) në praktikat e fesë islame.

Lëvizja selefije nuk është dhe nuk ka qenë kurrë lëvizje me synim kryesor *fikhun* kurse medhhebet s'jane gjë tjetër përveçse të tilla. Ajo dhe fikhu mbështesin dhe plotësojnë njëra-tjetrën. *Fikhu* i medhhebeve hedh bazat, mbi të cilat ngrihet kërkimi modern, ndërsa ideologjia e selefinjve identifikon dhe ndreq ato gabime që janë futur gjatë shekujve, në

<sup>20</sup> Të katër medhhebet pretendojnë një strukturë dinamike me burime për modifikimin progresiv të *fikhut* nisur nga dije të reja. Megjithatë, vështirë t'u gjesh prova ndryshimeve të tilla dhe po ashtu është e vështirë që të bëhen ndryshime në rrjedhën kryesore, nisur nga fakti se *fikhu* i medhhebeve, siç e kanë argumentuar gjerësisht, përbën një dëshmi relativisht përfundimtare. Imamët e të katër medhhebeve kanë thënë:

1. Ebu Hanife – “Kur hadithi është autentik, atëherë ky është medhhebi im” (Ibën Abidin, *El Hashijah*, fq. 1/63) dhe ... “nëse unë bëj një pohim të ndryshëm nga ai që është në librin e Allahut ose në thëniet e të Dërguarit të Tij, atëherë mos e merrni parasysht atë.” (El-Fulani, *I'kath El Himam*, fq. 50)
2. Maliku – “Unë jam vetëm një njeri; bëj gabime dhe nuk jam i drejtë ndonjëherë. Prandaj, shqyrtojini mendimet e mia; çdo gjë që pajtohet me Kuranin dhe me Sunetin, merrni, dhe çdo gjë tjetër që nuk pajtohet me to, lëreni!” (Ibn Abd El Berr, *El Xhami*, fq. 2/32).
3. Shafiu – “Kur hadithi është autentik, atëherë ky është medhhebi im” (En-Neveviu, *El Mexhmu*, fq. 1/136); “Çdo hadith nga Profeti të merret si opinioni im, edhe po të mos e keni dëgjuar prej meje (Ibn Ebi Hatimi, *Edeb El Shafi*, fq. 93-94); “Ekziston një konsensus midis muslimanëve, sipas të cilit, atij që i tregohet suneti i Profetit, e ka të ndaluar që ta lërë në këmbim të thënies së një tjetri, kushdo qoftë ai” (El Fulani, *I'kath El Himam*, fq. 68).
4. Ahmed ibën Hanbel – “Mos më ndiqni mua verbërisht, as Malikun, as Shafiun... por sunetin e të Dërguarit të Allahut...” (El Fulani, *I'kath El Himam*, fq. 113).

mënyrë klandestine, në besimet dhe në praktikat e muslimanëve. Aq i plotë dhe universal ka qenë infiltrimi i sufizmit apo *akideve* esharite ose maturidite në botën e medhhebeve, saqë, me kalimin e kohës, ato filluan që të konsiderohen si pjesë integrale e tyre. Por kjo nuk pasqyron mendimin e periudhës së fillimeve islame prandaj bota muslimane duhet tu jetë mirënjohëse selefijve për identifikimin dhe denoncimin e ketij fakti.

Kështu, njeriu mund ta kuptojë lehtësisht, përse lëvizja selefije dhe medhhebet konsiderohen shpesh në kundërshtim me njëra-tjetrën. Ndonëse në të vërtetë, ato nuk janë të tilla, pasuesit e këtyre shkollave, nuk ia dalin dot që t'i ndajnë gjërat në praktikë. Shumë selefinj injorantë e zhvlerësojnë *fikhun* e medhhebeve në mënyrë instiktive, si të thuash duke flakur edhe foshnjën së bashku me ujin e banjës, e kjo për faktin se nuk janë të aftë të dallojnë midis rëndësisë së *fikhut* të medhhebeve dhe devijimeve në besim e në praktikë, që u janë shtuar atyre përgjatë shekujve. Selefij të tjerë i shohin gabimisht si çështje kryesore dallimet në *fikh*, ndërkohë që në fakt, çështjet kryesore janë ato që u treguan më sipër. Nga ana tjetër, shpesh pasuesit e medhhebeve i shohin selefitë armiqësisht, për faktin se ideologjia e selefivë sfidon *akiden* dhe sufizmin, që ata kanë nisur t'i shikojnë si pjesë integrale të medhhebeve të tyre të veçantë. Natyrisht, kjo armiqësi është reale dhe në këto çështje, do t'i duhet çdokujt që të marrë thjesht njërën anë-pro ose kundër sufizmit, pro ose kundër *akideve* esharite e maturidite, etj. Megjithatë, duhet thënë se nuk është *fikhu* i medhhebeve, ai që sfidohet aq shumë, sa gabimet në *akide*, rrëshqitja drejt sufizmit, stanjacioni (amulli) i *fikhut*, ndjekja e verbër nga ana e pasuesve, si dhe zbatimi i praktikave joislame.

Muslimanët e ekuilibruar, e radhisin veten në rrugën e mesme, duke kërkuar të mirën midis të dyja grupeve, që, sipas mendimit të autorit, nënkupton njohjen e *fikhut* të medhhebeve, nga njëra anë, dhe meritën e reformave selefi, në anën tjetër.

Në fakt, të gjithë dijetarët që rigjallëruan ideologjinë selefije (si Sheik el-Islam Ibn Tejmije, Ibn Kajjim el-Xheuzije si dhe Muhamed ibn Abdul-Vehabi), i nisën studimet e tyre si përkrahës të njërit prej medhhebeve tradicionale, e konfirmuan këtë rrugë të dijes e nuk synuan kurrë që të përmbysnin ndonjërin nga këto shkolla të *fikhut*. Ata kërkuan që t'i rigjallëronin medhhebet, por, në të njëjtën kohë, të reformonin rrugën, në të cilën u pasuan. Për më tepër, asnjë nga këta dijetarë nuk pretendoi ndonjëherë, se kishte themeluar një shkollë të re të *fikhut*, pavarësisht nga fakti që, nisur nga edukimi shkollor dhe popullariteti i tyre, ata mund ta kishin krijuar, po ta kishin menduar të përshtatshme. Dhe, në fakt, gjatë mijëvjeçarit të fundit, shumica dërrmuese e muslimanëve, laikëve e dijetarëve (duke përfshirë dhe dijetarët selefi), kanë aderuar në njërin nga katër medhhebet tradicionalë.

Në dritën e gjithë sa u tha më lart e duke patur parasysh faktin se shumica e muslimanëve kanë ndjekur *fikhun* e medhhebeve për mbi njëmijë vjet, kushdo do mund të kujtonte hadithin që tregon se Muhamedi (a.s.) ka thënë: “*Umeti* im nuk do të bashkohet kurrë mbi bazën e një gabimi”.<sup>21</sup>

<sup>21</sup> Tirmidhiu (2167), Ibn Maxhe (3950), Ahmedi (17060).

Disa dijetarë (zakonisht nga ata të medhhebeve), e quajnë të detyrueshme ndjekjen e një medhhebi nga njerëzit e zakonshëm, kurse të tjerët jo (përgjithësisht pjesëtarët e lëvizjes selefije). Cilido mendim që të pranohet, do të ishte mirë që pothuajse të gjithë dijetarët, pavarësisht nga shkolla, të njihnin dhe të respektonin *fikhun* dhe katër medhhebet.

Në mënyrë të ngjashme, meritat e lëvizjes së selesfinjve janë të shumta dhe pak a shumë të qarta. Së pari, nëse udha e selesfinjve përkufizohet si udhë e imitimit të paraardhësve të drejtë dhe e më të mirëve të këtij *umeti* të Islamit, pra, të shokëve të Muhamedit (a.s.), atëherë, a nuk do duhej që të gjithë muslimanët të synonin fitoren e saj? Cili musliman nuk do pëlqente të ishte *selef*? Së dyti, nëse lëvizja e selesfinjve përkufizohet si një lëvizje për ndreqjen e devijacioneve të sipërpërmendura, a nuk do duhej që të gjithë muslimanët të synonin anëtarësimin në të? Problemi, pra, qëndron vetëm te fakti se, lidhur me *fikhun*, nuk ka marrëveshje për korpusin e mësimëve që përcaktohen si *fikhu* i lëvizjes së selesfive. Më saktë, ka shumë libra dhe traktate, disa të shkurtra, si pamflete, të tjerët në libra voluminoze (të tilla si mësimet dhe *fetvatë* e Sheik el-Islam Ibn Tejmijes), të cilët plotësojnë korpusin e literaturës së *fikhut*. Dhe meqë shumë nga këto libra janë përkthyer në anglisht, ato janë të disponueshme në përmasa praktike e jashtezakonisht të dobishme. Megjithatë, të argumentosh se këto libra zëvendësojnë *fikhun* e katër medhhebeve, kjo do të krijonte një situatë të pasigurtë dhe një shkak për grindje dhe ndarje të shumta midis atyre që diskutojnë çështje të tilla.

Pra, të dyja grupet, medhhebet dhe selesfitë, kanë të mirat e tyre, mjafton që të njihen fuqitë e kufizimet e tyre. Natyrisht, ka dhe nga ata të skajeve ekstreme, të cilët dënojnë kategorikisht çdo shkollë që është ndryshe nga e tyre, por muslimanët më të moderuar, kërkojnë një rrugë të mesme mes këtyre ekstremeve, duke pranuar të mirat e të dyjave, si të *fikhut* të medhhebeve, ashtu dhe të reformave të lëvizjes selefije. Kjo është, pikërisht, ajo që propagandojnë dijetarët selefi, kur aplikojnë mësimet e tyre të *akides* e pastrimit të shpirtit (që kanë të bëjnë me refuzimin e mësimëve me prejardhje nga shkollat e esharitit dhe maturidit për *akiden*, dhe të sufizmit për pastrimin shpirtëror, në favor të mësimëve të qarta të Kuranit, Sunetit dhe të tre brezave të parë të muslimanëve të devotshëm), si dhe me një medhheb të veçantë në lidhje me *fikhun* (por duke mbetur të kujdesshëm për t'u dhënë prioritet dëshmimeve islame mbi mësimet e secilit medhheb, sa herë që këto të dyja bien në konflikt, duke shmangur, në këtë mënyrë, gabimin e ndjekjes verbërisht).

Duke u rikthyer te subjekti i librave të *fikhut*, *Fikhus-Sunneh*, nga Sejid Sabik, është gjerësisht i pranuar dhe një libër i vlefshëm për të sapokthyerit në Islam. Megjithatë *Fikhus-Sunneh* nuk është përkthyer plotësisht në anglisht e shumë vetë e shikojnë me pakënaqësi një gjë të tillë, pikërisht, për shkak të mungesës së hollësirave.

Aktualisht, librat e vetëm të medhhebeve, që ofrojnë një informacion të bollshëm dhe që janë përkthyer denjësisht, janë ata të Nuh Ha Mim Kellerit (*El-Nawawi's Manual of Islam* dhe *Reliance of the Traveler*). Edhe pse ky autor është kritikuar për lidhjet e tij me sufizmin dhe promovimin e *akides* së Eshariut, si dhe për disa komente që ai bën në librat e tij, këta të fundit vlerësohen për saktësinë e përkthimit. Është gjë e mirë që komentet personale të Kellerit shënohen me një "n" të vogël, e cila paraprin secilin koment, sepse

në këtë mënyrë, lexuesi ka mundësi që të dallojë përkthimin që është shumë i vlerësuar nga komentet personale të Kellerit që s'janë aspak të tilla. Kritika e tij për Sheik el-Islam Ibn Tejmijen, në veçanti, edhe duhej pritur, po të kemi parasysh faktin që ky dijetar i ka kundërshtuar shkollat e *akides* dhe sufizmin, të cilët aderonte Kelleri. Shënimet e Kellerit për sufizmin dhe *akiden* janë aq evidente, saqë reflektojnë lehtësisht anësinë e tij ndaj këtyre subjekteve.

Në libraritë islame dhe në internet mund të gjenden argumente pro e kundra medhhebeve, selefive, *akideve* të Eshariut dhe Maturidit, Sejid Sabikut, Nuh Kellerit, e madje edhe pro apo kundra metodologjisë së përpjekjeve për ta rinxjerrë *fikhun* nëpërmjet analizës personale të Kuranit dhe Hadithit (një disiplinë, të cilën dijetarët e njohin si territor ekskluziv vetëm të tyre). Megjithatë, do të pohoja për hir të lexuesve që një nga artikujt më të shkëlqyer në lidhje me medhhebet është artikulli i shkurtër *Understanding The Four Madhhabs*, nga Abdal Hakim Murad.

### 3. PRAKTIKA

Sapo të kthyerit në fe e përqafojnë Islamin nëpërmjet deklaramit të *shehadetit*, mbi ta bie detyrimi i shtyllave të Islamit, siç e diskutuam më lart. Mësimi e zbatimi i këtyre shtyllave bëhet gur prove, nga i cili varet feja e personit, dhe këtë e mundëson zgjedhja dhe ndjekja e njëres prej shkollave të respektuara të *fikhut* të Islamit (suni)<sup>22</sup>. Nëse do duhen bërë kërkime për medhhebet, është mirë të mos gjykohet njëri medhheb si më i mirë se tjetri, por të konsiderohen të katërt si barasvlera të shkëlqyera të njëri-tjetrit, duke iu përkushtuar, kështu, mësimëve të atij medhhebi, që është më i disponueshëm. Për shumicën e muslimanëve në Amerikë e Angli, rezultoi se më lehtësisht mësohet medhhebi Shafi, thjesht sepse librat e medhhebeve të tjera, nuk janë përkthyer në anglisht me të njëjtën shkallë cilësie.

Vlera të spikatura kanë gjithashtu librat e promovuar nga shoqatat “Selefi” dhe “Kurani e Suneti”, sepse shpesh herë kanë përmbajtje të dobishme e përmasa të përshtatshme, dhe janë shkruar nga dijetarë kompetentë. Megjithatë ka dhe shumë të tjerë nën standardet e nivelit akademik, që reflektojnë më shumë opinionet e autorit se sa mësimin e *ulema-ve*. Kështu që njeriu duhet t’i besojë udhëzimit nga Allahu dhe rekomandimeve të vëllezërve e të motrave në besim, duke mbetur përzgjedhës dhe kritik në të njëjtën kohë.

Nga ana tjetër, shumë të sapokthyer zgjedhin që të ndjekin mësimet e kujtdo imami apo dijetari që ndodhet më pranë, që zakonisht është imami i xhamisë lokale. Në varësi nga individi i interesuar, kjo mund të rezultojë edhe si një zgjidhje e pasuksesshme, për faktin se shumica e imamëve në Perëndim, nuk e kanë kualifikimin dhe nivelin e duhur, ndërkohë që disa janë të korruptuar, dhe plot të tjerë, pastaj, të drejtojnë në udhë të gabuar, me qëllim apo vetëm nga padija. I sapokthyeri bën mirë që ta ketë parasysh një gjë të tillë dhe të kapet fort pas mësimëve të dijetarëve tradicionalë e të respektuar, që paraprijnë me paraqitjen e tyre të shkëlqyer.

Fatkeqësisht, një gabim i zakonshëm, është besimi në mendimin e kujtdo muslimani “etnik”, që nënkupton muslimanët e lindur në vendet islame. Kjo mund të trondisë të sapokthyerit, por është fakt që shpesh, muslimanët “etnikë” të Perëndimit, janë përfaqësuesit më të këqinj të Islamit. Në fakt, këta muslimanë i japin Islamit imazh të keq, dhe në vend që t’i ndihmojnë të sapokthyerit, ua bëjnë konfuze dhe të vështirë jetën në fenë e tyre të re. Kjo, natyrisht, nuk është e vërtetë në të gjitha rastet, por ia vlen të përmendet, sepse ndodh mjaft shpesh.

Arsyet pse muslimanët “etnikë” nuk mund të jenë shembujt më të mirë, mund të jenë të shumta, por ka rëndësi fakti që shumë prej tyre shkojnë në Perëndim për një qëllim të caktuar, dhe ky qëllim shpeshherë mund të jetë çdo gjë tjetër përveç fesë. Po të flasim hapur, shumë muslimanë “etnikë” emigrojnë në kërkim të *dynjasë* (të gjërave materiale të kësaj bote), duke ikur nga vendi i muslimanëve për në vendin e jobesimtarëve. Këta janë muslimanët që i kanë dhënë prioritet jetës së kësaj bote mbi fenë, duke bërë kompromis me njërin në kurriz të tjetrës, kështu që nuk mund të shpresohet se ata do jenë midis

---

<sup>22</sup> Pa e ndjekur vebërisht dhe pa kaluar në ekstreme.

përfaqësuesve më të mirë të Islamit. Në fakt, ka shumë që e lënë Islamin, kur largohen nga brigjet e vendeve të tyre, po ta kenë praktikuar atë ndonjëherë, sigurisht. Në fakt, shumë prej tyre nuk e kanë bërë këtë. Megjithatë, ka disa individë që hasin vështirësi të tilla që i motivojnë t'i kthehen fesë përsëri, dhe një përqindje e caktuar e tyre bëhen vërtetë muslimanë më të mirë, sesa ata që kanë lënë pas, në vendet e tyre amtare. Po ashtu, ka shumë muslimanë të mirë që kanë emigruar në Amerikë, Angli dhe Europë, me qëllim që t'i shpëtojnë persekutimit në vendet e tyre të lindjes, apo thjesht për faktin se kanë qenë muslimanët më të mirë praktikues në ato vende ku i persekutojnë ato. Rrjedhimisht, përzjerja e muslimanëve "etnikë" është me të vërtetë një kolazh i shumëngjyrshëm profilesh fetare, që varion nga më të këqinjët tek më të mirët.

Pra, i sapokthyeri nuk duhet të presë që të gjithë ata të jenë shenjtorë dhe engjëj. Vetëm një pakicë shumë e vogël e kupton një gjë të tillë.

Në të njëjtën mënyrë, i sapokthyeri duhet të përgatitet për të kaluar vështirësi të ndryshme kur futet në Islam. Shpeshherë, ai konstaton se vuan sprovat e besimit pikërisht në ato gjëra që u jepte më tepër prioritet në jetën që bënte përpara islamit. Pavarësisht nëse kjo është çështje e shëndetit, pasurisë, jetës bashkëshortore, fëmijëve, apo çdolloj gjëje tjetër, i sapokthyeri në fe duhet të presë sprovat, sepse vështirësia është provë e sinqeritetit. Disa e kalojnë, disa dështojnë e, më në fund, këto sprovat ia dalin të përzgjedhin të pasinqertin nga "e korra e shëndetshme" e besimtarëve të vërtetë e të sinqertë.

Rëndësi ka që besimtari nuk vuan në udhën e Allahut e që Allahu të mos ia kompensojë në këtë botë apo në tjetrën, shumë herë më tepër sesa vlera e çdolloj gjëje që ai ka braktisur për hir të kënaqësisë së Tij. Kështu, ashtu siç i këshilloi Muhamedi (a.s.) ata që u kthyen në fe në kohën e tij, gjithashtu, i kthyeri në kohët tona duhet që të këshillohet, që t'i presë e të përgatitet për vështirësitë. Për këtë, Muhamedi (a.s.) ka thënë: "*Allahu e sprovon atë që ia do të mirën*".<sup>23</sup> Pas këtyre testeve e provave, muslimani mund të jetë i sigurtë për marrjen e shpërblimit për durimin dhe qëndrueshmërinë në udhën e së vërtetës. Në një hadith tjetër, Muhamedi (a.s.) ka thënë:

*"Nuk ka gjë që e mundon besimtarin, qoftë edhe një gjemb që e shpon, e që Allahu të mos i ketë shkruar, për shkak të saj, një punë të mirë e të mos i ketë fshirë një punë të keqe."*<sup>24</sup>

si dhe

*"Nuk ka gjë që e mundon besimtarin, qoftë dhimbje, pikëllim apo lodhje, e që Allahu të mos i fshijë, për shkak të saj, disa nga mëkatet e tij"*.<sup>25</sup>

Sikur të mos mjaftonte kjo, feja mëson se urtësia e Allahut i kompenzon punët e mira në masën dhjetë deri shtatëqind herë sa vlera e punës së mirë, siç thotë hadithi:

<sup>23</sup> Buhariu (5321), Maliku (1684), Ahmedi (7234).

<sup>24</sup> Buhariu (5317), Muslimi (2572).

<sup>25</sup> Tirmidhiu (966).

*“... Atij, që ka synuar një punë të mirë, por nuk e ka bërë, Allahu ia regjistron si punë të mirë të plotë; e nëse e ka synuar dhe e ka bërë, Allahu ia regjistron dhjetë deri në shtatëqind, bile dhe më shumë herë si punë të mirë...”*<sup>26</sup>

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se muslimani duhet të kërkojë sprova dhe probleme, apo t’ia bëjë të mundimshme jetën vetes. Në Islam nuk lejohet monasticizmi (mënyra e jetesës së murgjve në një manastir) dhe muslimanët inkurajohen që ta bëjnë jetën të lehtë për veten e tyre. Për fat të mirë detyrimet minimale fetare përmbushen lehtësisht. Nëse muslimanët do ta ndjenin veten të paaftë për të respektuar njërën apo disa nga shtyllat e Islamit, kjo zakonisht reflekton më tepër faktin se ata nuk e dinë se mund të aplikohet për një përjashtim nga detyrimi sesa mungesën e fleksibilitetit të fesë. Islami nuk është një fe e ngurtë. Për shembull, nëse lind nevoja, njeriu mund të falet ulur, ose edhe shtrirë. Njeriu që është i paaftë për të agjëruar Ramazanin, mund t’i plotësojë më vonë ditët e humbura ose mund t’i kompensojë, duke ushqyer të varfërit. Burri ose gruaja që nuk mundën ta kryejnë *haxhin*, mund të pajtojnë dikë tjetër për të shkuar në vend të tij apo të saj. Pra, muslimanët që e konsiderojnë veten të paaftë për të respektuar një ose më shumë shtylla të Islamit, në fakt, nuk njohin fleksibilitetin e praktikës islame, e cila mund t’u përshtatet të gjitha rrethanave të gjendjes njerëzore.

Kjo është një çështje mjaft e rëndësishme, sepse shumë muslimanë të rinj përpiqen që ta zbatojnë Islamit në jetën e tyre në mënyrë strikte, ndonjëherë me një zell e pedantizëm të atillë, që shpie në rezultatin e parashikueshëm të shastisjes e armiqësimit të të tjerëve. Mos bëni kështu! I Dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.) ka thënë: “Vërtet, kjo fe është e lehtë dhe asnjë nuk është mizor ndaj vetes duke e zbatuar atë, përveçse kur e tejkalon. Prandaj, ndërmerrni hapat e duhur, qasuni, përgëzoni e kërkoni ndihmë përmes lutjes në mëngjes e në mbrëmje, si dhe me pak falje natën”.<sup>27</sup> Për më tepër, Muhamedi (a.s.) ka thënë (duke e përsëritur tre herë për ta theksuar): “Vërtet që ekstremistët janë të shkatërruar”.<sup>28</sup>

Pra, muslimani i ri duhet ta zbatojë Islamit tërësisht, por me qetësi e lehtësi kur bëhet fjalë për praktikën dytësore të tij. Nëse do të rekomandoja disa nga praktikat “*bëj*” e “*mos bëj*”, ato do të ishin:

- 1. Shmang ekstremet!** Përqendrohu në mësimin e bazave të fesë, duke u fokusuar në mësimin e udhëve të pranueshme alternative të bërjes së gjërave, nëse do lindë nevoja. Mëso lidhur me përjashtimet nga detyrimet dhe kushtet kur ato lejohen, siç treguam më lart. Fleksibiliteti i Islamit është një bekim. Mos u tregoni të ngurtë e kokëfortë as me veten dhe as me të tjerët, se, po të bëni kështu, diçka do të thyhet herët apo vonë. Lidhur me vetveten, Muhamedi (a.s.) i paralajmëronte muslimanët: “Ndiqni rrugën e mesme, sepse kushdo që përpiket ta mbingarkojë

<sup>26</sup> Buhariu (6126), Muslim (206).

<sup>27</sup> Buhariu (31).

<sup>28</sup> Muslimi (2670).



veten në fe, do të pësojë disfatë”.<sup>29</sup> Në një hadith tjetër thuhet: “*Kjo fe është e lehtë dhe kushdo që përpiqet ta mbingarkojë veten në të, do të pësojë disfatë. Jini të mesëm dhe përpiquni ta përsosni veprimin tuaj aq sa keni mundësi ...*”.<sup>30</sup> Lidhur me trajtimin që ne u bëjmë të tjerëve, edhe vetë Muhamedi (a.s.) është këshilluar nga Allahu për këtë:

“*Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj, falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme...*” (Kuran, 3:159);

2. **Syno rrugën e mesme në të gjitha gjërat.** Islami është feja e rrugës së mesme. Po të thellohesh, edhe urdhëresat e ashpra, që s’pranojnë kompromis në dukje, do kuptosh që janë një udhë e mesme mes ekstremeve shumë më të këqija;
3. **Bëhu modest, i përvuilur dhe mëso sjelljet islame** sa më shpejt që të jetë e mundur – jo vetëm për veten, por edhe për hir të familjes, miqve dhe bashkëpunëtorëve. Vëllezërit dhe motrat në Islam mund të të falin për gabimet në fe dhe sjelljet jo të mira të fillimeve të tua, por miqtë dhe familja jo. Ka të ngjarë që ata të të kenë mbajtur nën vëzhgim që nga dita e parë, kështu që përshtypja më e mirë, arrihet duke shfaqur sjelljet më të mira. Për rëndësinë e kësaj çështjeje, Muhamedi (a.s.) ka thënë: “*Unë jam dërguar për të përsosur sjelljet e mira*”.<sup>31</sup>
4. **Mos u merr me debate!** Zakonisht të sapokthyerit nuk zotërojnë mjete intelektuale për debate fetare kështu që çështjes së *daves* islame do ti shërbejë më mirë duke mos folur për të por duke kaluar disa nga ato libra, shkrime apo kaseta që i tronditën fillimisht vetë zemrat dhe mendjet e tyre. Pasi të kesh marrë njohuritë e duhura, ji i duruar, jep shembullin e mirë dhe paraqite Islamin në mënyrën më të mirë;
5. **Qëndroji pranë xhamisë dhe bashkësisë islame.** Fuqia dhe kuptimi i thellë i gjërave nga vëllezërit e motrat në besim mund të rezultojnë teper të çmueshme e inkurajuese. Nga ana tjetër, miqtë dhe familjarët, që nuk besojnë, përpiqen shpesh herë që ta kthejnë një person nga Islami dhe mund ta dobësojnë vendosmërinë e tij. Mos bëj lëshime në fenë tënde për hir të ndokujt. Një gjë e tillë konsiderohet si vepër mosbesimi;
6. Nëse të dobësohet besimi, siç u ndodh shumë të kthyerve në fe herë pas here, **rikthehu përherë te shehadeti** dhe pyete veten nëse beson se nuk ka tjetër që duhet adhuruar, përveç Allahut, dhe se Muhamedi (a.s.) është I Dërguari i Tij i fundit. Nëse je i bindur për këtë, mbështetu në fenë tënde, sepse Allahu është i mjaftueshëm për besimtarët;
7. **Lehtësoje veten sadopak në praktikat islame të dorës së dytë,** të tilla si faljet dhe agjërimi vullnetar. Veprimet shtesë të adhurimit e ruajnë besimtarin nga mosbesimi, sepse kushdo mund të përjetojë luhate ne iman. Nëse ndodh kjo, atëherë besimtari do të konstatojë se po humbet një apo më shumë nga lutjet e agjërimet e tij dytësore, nëse ka praktikuar lutje e agjërimet të tilla, po jo dhe nga veprimet e kërkuara të adhurimit, *inshallah*. Nga ana tjetër, ata që kryejnë vetëm minimumin e thjeshtë të detyrimeve, nuk kanë më se çfarë të lënë, përveçse ato që

<sup>29</sup> Ahmed (4/422).

<sup>30</sup> Buhari (39), En-Nisa’i (8/121).

<sup>31</sup> Ahmed (8939), Buhari - *El-Adeb El-Mufrad* (273), Maliku (1609).

kërkohen. Po ta bëjnë një gjë të tillë në një çast dobësie, do të vinin në pikëpyetje veprimet e detyrueshme të adhurimit. Siç shprehet një mësues, “Po të lihet *suneti* (veprimet dytesore të adhurimit), më në fund do të hiqet dorë dhe nga *farzi* (veprimet e detyruara)”.

8. **Mbaj lidhje me muslimanët**, që njihen si *Ehklus-Sunneh uel Xhema*’ (që do të thotë, grupi i njerëzve të Sunetit}. Siç e thamë më lart, Muhamedi (a.s.) ka përçarur mësimin: “Do të jetë gjithmonë një grup nga *umeti* im që do të qëndrojë fort në të vërtetën deri Ditën e Gjykimit”.<sup>32</sup> Dhe cili është ky grup? Kur bëhet kjo pyetje, disa prej dijetarëve më të mëdhenj të Islamit (Imam Ahmedi, Imam Buhariu, Ali Ibn el-Madani, Jahja Ibn Ma’in, Ibn el-Mubarek, Sufjan et-Tauri, dhe shumë të tjerë), thonë se grupi në rrugën e drejtë, i përgjigjet pasuesve të Hadithit, pra *Ehklus-Sunneh uel Xhema*’. Për këtë, Muhamedi (a.s.) ka thënë: “Vërtet, ai që do jetojë gjatë mes jush, do të shohë përçarje, prandaj ndiqni traditën time dhe të kalifëve të drejtë. Kini kujdes nga çështjet e shpikura, sepse çdo çështje e shpikur është risi dhe çdo risi është devijim”.<sup>33</sup>
9. **Mëso ta lexosh Kuranin në Arabisht**. Edhe nëse nuk kupton në gjuhën arabe, thjesht recitimi i Kuranit mund të jetë një burim qetësie, paqeje dhe kënaqësie.
10. **Mësoje gjuhën arabe**. Përderisa Kurani dhe Suneti janë bazat e Islamit, atëherë gjuha arabe është baza e vlerësimit dhe e kuptimit të tyre.
11. **Eksploroje botën muslimane!** Nëse është e mundur, shikoje seroizisht mundësinë për të bërë *hixhret* (emigrim) në një nga vendet islame. Por, ky emigrim nuk duhet marrë lehtësisht, sepse mjaft të kthyer përëndimorë janë zhgënjyer shumë nga të metat e jetës dhe të fesë në vende të tilla. Vlerësoje këtë hap me kujdes dhe fillo me vizita on-site, nëse është e mundur. Por, mos harro se, ashtu si shumica e muslimanëve “etnikë” janë larg së qeni shenjtorë, edhe vendet muslimane, janë shpeshherë, larg së qeni islame. Megjithatë, këto janë vendet e vëllezërve dhe të motrave në besim. Jeta midis tyre dhe dhënia e ndihmesës në shoqërinë ku ata jetojnë, i justifikon vështirësitë që mund të hasen. Sidoqoftë, jeta si musliman, duke përfshirë edhe *hixhretin*, shoqërohet me prova të ndryshme.
12. **Zgjidh një rrugë, në të cilën mund t’i shërbesh më mirë Allahut**. Të jetuarit si musliman që s’ka pikësynim apo qëllim tjetër, përveç kryerjes së pesë lutjeve dhe agjërimit të Ramazanit, mund të jetë një fakt mjaft i cekët dhe zhgënjyes. Shumë muslimanë aspirojnë për arritje më të mëdha dhe, kur e gjejnë rolin e tyre brenda fesë, nisin të përjetojnë pasurinë e vërtetë të besimit. Një person mund të studiojë, një tjetër mund të thërrasë në Islam, tjetri t’u bashkohet programeve sociale të shpërndarjes apo t’ia kushtojë kohën e tij bashkësisë. Çfarëdolloj zgjedhjeje që të bëjë një person, të kujtohet që çdo dhuratë që i bëhet Allahut sjell shpërblime në të tashmen dhe në të ardhmen, dhe pikërisht kjo është çimentua e vërtetë që kompletton dhe vulos besimin e njeriut

<sup>32</sup> Buhariu (3441), Muslimi (156), Ebu Daudi (4252), Tirmidhiu (2229).

<sup>33</sup> Tirmidhiu (2676).

#### 4. IHSANI (PERCEPTIMI I ZOTIT)

Nga hadithi i Gabrielit që cituam më lart, mësuam kuptimin e *islamit*, *imanit* dhe *ihsanit*. Kush e ka lexuar *Urdhrin e Parë e të Fundit* ka vënë re se struktura e librit bazohet në gjashtë përbërësit e besimit islam, siç përkufizohen nga ky hadith (pra, besimi në Allahun, Engjëjt, Librat e shpalljes, Të Dërguarit e Tij, Ditën e Gjykimit dhe Urdhrin Hyjnor). Kjo strukturë ka qenë e qëllimshme, sepse hadithi në fjalë konkludon se Gabrieli, engjëlli i shpalljes, ishte dërguar për të treguar elementet më të rëndësishme të fesë islame. Prandaj, ç' model tjetër duhet ndjekur për mësimin e fesë?

Islami është diskutuar në *Urdhrin e Parë e të Fundit*, ndërsa elementet e *imanit*, duke qenë shtylla të besimit, janë parë shkurtimisht në kapitullin e dytë të këtij libri. Mbetet diskutimi i *ihsanit* për të plotësuar mësimet e hadithit të Gabrielit.

Sipas hadithit, *Ihsan* do të thotë "... të adhurosh Allahun sikur e sheh, se, edhe pse ti nuk e sheh Atë, [ti e di që] të shikon Ai ty". *Ihsani* është vetëdija për Zotin në të gjitha gjërat dhe në të gjitha kohët. Perfeksionimi i *Ihsanit* shpie në perfeksionimin e fesë dhe të adhurimit, se njeriu i *Ihsanit* është jashtëzakonisht i vetëdijshëm që çdo mendim, fjalë apo veprim i tij, është i njohur për Allahun dhe regjistrohet. Kështu, ky njeri nuk i kompromenton asnjëherë detyrat e fesë, sepse edhe kur është vetëm në raport me njerëzit e tjerë, ai është i vetëdijshëm për praninë e engjëjve regjistruar si dhe për gjithëdijshmërinë e Allahut.

Por, si ta zhvillojnë dhe perfeksionojnë njerëzit *Ihsanin* e tyre? Vetëdija për Zotin rritet me sigurinë e besimit, i cili rrjedh nga edukimi fetar, në kombinim me përvojën kronologjike dhe shpirtërore. Pikërisht këtu, gjërat bëhen problematike.

Vlera e edukimit fetar është e qartë; pritet të jetë kështu edhe përvoja e kësaj bote nga jetimi i fesë. Po përvoja shpirtërore? Kjo është çështja, ku shumë muslimanë futen në labirinte. Gjë, e cila na shpie në një diskutim rreth sufizmit.

## 5. SUFIZMI

Sufizmi mund të jetë një element turbullues për një të sapokthyer në fe. Te rinjtë në Islam studiojnë përgjithësisht një larmi të madhe grupesh, ndër të cilët sufitet janë nga ata që janë më tërheqës e që pëlqehen, pjesërisht në sajë të mikpritjes së tyre të madhe, të personaliteteve të tyre të ngrohta e dashamirëse dhe lëshimeve, nëpërmjet të cilave e propagandojnë fenë (disa grupe kanë shkuar aq larg, sa e kanë modifikuar atë, në fakt). Për më tepër, shumë individë duket se kanë gati-gati një prirje të lindur mendore për rrugët që i fokusojnë mësimet dhe aspiratat e tyre drejt spiritualizmit.

Puna është se kushdo që ndjek të vërtetën e Allahut, është i detyruar të përjetojë një nivel të caktuar spiritualizmi, sepse ata që meritojnë kënaqësinë e Tij, presin me të drejtë që Ai t'u japë kuptim dhe shikim të thellë shërbëtorëve të tij të sinqertë. Në një hadith kudsij thuhet:

Allahu i Lartësuar ka thënë: *“Kushdo që tregon armiqësi ndaj një mikut Tim, Unë do të jem në luftë me të. Skllavi Im (pra, muslimani besimtar) nuk më afrohet me gjë, që Unë ta dua më shumë sesa me detyrat fetare që i kam vënë për detyrim. Ai vazhdon të më afrohet me veprime më të shumta se ato, që Unë ta dua. Kur Unë e dua, atëherë bëhem dëgjimi i tij, me të cilin dëgjon, shikimi i tij, me të cilin shikon, dora e tij, me të cilën mban, e këmba e tij, me të cilën ecën. Nëse ai do të kërkonte [ndonjë gjë] prej Meje, Unë do t'ia jepja me siguri, e po të më kërkonte Mua për mbrojtje, Unë do ta mbroja”.*<sup>34</sup>

Gjithashtu, në një tjetër hadith, Allahu thotë:

*“Unë jam me shërbëtorin Tim kur ai më kujton. Nëse ai më kujton me veten e vet, Unë do ta kujtoj me Vetën Time. Nëse ai më përmend mes një grupi njerëzish, Unë do ta përmend mes një grupi më të mirë. Nëse ai më afrohet një pëllëmbë, Unë i afrohem një pash. Nëse ai më afrohet një pash, atëherë Unë i afrohem deri në largësinë e krahut. E nëse ai vjen tek Unë duke ecur, Unë do të shkoj drejt tij duke vrapuar”.*<sup>35</sup>

Nga këto mësimet muslimanët kuptojnë që, sa më shumë që ata të punojnë për kënaqësinë e Allahut, aq më i madh është shpërblimi i Allahut dhe afërsia e Tij. Kështu, sapo një njeri angazhohet në mësimet e Allahut, veprimet e tij mund të shpërblehen në më shumë se një fushë.<sup>36</sup> Të dyja periudhat, ajo e qetësisë dhe ajo e provave, ndeshen në këtë jetë tokësore, po të dyja këto gjendje duket se shoqërohen me vetëdije shpirtërore te ata muslimanë që janë konfirmuar në pikëpamje të sigurisë e të angazhimit në fenë e tyre.

---

<sup>34</sup> Buhariu (6137).

<sup>35</sup> Buhariu (6970), Muslimi (2675), Ahmedi (7416), Ibën Maxhe (3792, 3822).

<sup>36</sup> Kjo nuk do të thotë se shpërblimi i një njeriu të përkushtuar do të merret domosdoshmërisht në këtë jetë. Allahu mund të zgjedhë sprovimin e të devotshmit me vështirësi në këtë jetë kalimtare, duke ia rezervuar shpërblimin për në botën e përtejme. Kështu, profetët dhe shumë nga njerëzit e dashur të Allahut, kanë bërë jetë të keqe në këtë botë, por kanë siguruar shpërblime të mëdha në parajsë.

Në këtë kuptim, dallimi mes muslimanëve josufi dhe sufive, është orientimi i tyre. Josufitë përqipen t'i fokusojnë përpjekjet e tyre në mësimin e doktrinës (*akides*), ligjeve (*fikhut*), sjelljeve të mira dhe kufizimeve praktike të fesë islame, në mënyrë të tillë që të sigurojnë korrektesën e besimit e të praktikës. Këta muslimanë e jetojnë jetën e tyre në mënyrën më të plotë, duke kërkuar kënaqësinë e shpërblimin e Allahut, duke iu frikësuar ndëshkimit të Tij, si dhe thjesht nga dashuria për Allahun. Si rezultat i këtyre, mund të pasojë një vetëdije e lartësuar shpirtërore, por kjo nuk përbën një objektiv në vetvete. Së pari, rëndësia më e madhe i kushtohet saktësisë së *akides* (doktrinës), *ibadetit* (adhurimit) dhe praktikës, sepse përmes tyre, sigurohet shpëtimi e mund të tërhiqet mbi vete kënaqësia e Allahut. Pa saktësi në *akide*, *ibadet* dhe në praktikë, asnjë thellësi e misticizmit nuk do të sillte shpëtim. Kështu, muslimanët josufi thjesht angazhohen në fe, studim e praktikë, në pajtim me burimet më të respektuara (pra me Kuranin, Sunetin dhe interpretimin e tyre nga dijetarët e respektuar). Në këtë rrugë, shpirti pastrohet, e kjo sjell një ngritje të gjendjes shpirtërore, që është një pasojë e parashikueshme, ndonëse jo një objektiv primar.

Nga ana tjetër sufite, gjatë përpjekjeve për të arritur përvoja mistike e lartësi shpirtërore, duket se i shmangen shpeshherë studimit e praktikimit të rregullave të Islamit. Ata që përqendrohen në radhë të parë tek misticizmi, priren që të sakrifikojnë korrektesën kritike të *akides* dhe praktikimin korrekt të shtyllave të Islamit, gjë që shpie zakonisht në kompromentimin, bile, shpesh edhe në diskutimin e përkatësisë së tyre islame. Shumë sufi kanë prirjen e rinovimit të fesë. Po të kujtojmë parimin e përgjithshëm, që çdo veprim adhurimi është i ndaluar, me përjashtim të atij që urdhërohet, mund të kuptojmë pse Ibn Mesudi (një nga sahabët më të mëdhenj), këshillonte me këto fjalë:

*“Paso, mos rinovo, sepse vërtet që të është dhënë diçka (d.m.th. feja islame), e cila është e plotë”.*<sup>37</sup>

dhe

*“E mesmja në ndjekjen e Sunetit është më e mirë se përfshirja e vetvetes në bidat (d.m.th. risi)”*<sup>38</sup>

Ibn Umeri (një tjetër nga sahabët e famshëm) transmetohet se e ka përforcuar këtë mësim me shprehjen: “Çdo risi është udhëzim i gabuar, edhe nëse njerëzit e shikojnë si diçka të mirë”.

Një histori më e gjatë, po mjaft kuptimplotë, mund të ndihmojë për ta përmbledhur atë që thamë më lart. Tregohet se Ebu Musa El-Eshariu i ka thënë Ibn Mesudit:

*“Pashë në xhami një grup njerëzish ulur në rrathë, që prisnin për lutjet. Në secilin rreth ishte një drejtues dhe tek çdo grup kishte guralecë, e ky drejtues u thoshte: “Thoni ‘Allahu Ekber’ (d.m.th. Allahu është më i madhi) 100 herë”, dhe ata thoshin ‘Allahu Ekber’ 100 herë (duke përdorur guralecët për të numëruar); dhe ai*

<sup>37</sup> Derami (205).

<sup>38</sup> Beihakiu (4522), Derami (223).

u thoshte: “Thoni ‘*La ilahe il Allah*’ (d.m.th. nuk ka zot që vlen të adhurohet përveç Allahut) 100 herë,” e ata thoshin “*La ilahe il Allah*” 100 herë (duke përdorur guralecët për të numëruar); Ai u thoshte: “Thoni ‘*Subhanallah*’ (d.m.th. Lavdi pastë Allahu) 100 herë,” dhe kështu ata thoshin “*Subhanallah*” 100 herë (duke përdorur guralecët për të numëruar). Atëherë, Ibn Mesudi iu kthye Ebu Musait: “Pse nuk u the që të numëronin mëkatet e tyre dhe të garantonin që asnjëra nga punët e tyre të mira, nuk do të humbiste?” Më pas, Ibn Mesudi u afrua pranë njërit prej rrathëve dhe u tha: “Çfarë është kjo që po bëni?” Ata iu përgjigjën: “O baba i Abdur-Rahmanit! Me guralecët ne numërojmë *tekbirin* (*Allahu Ekber*) tonë, *tehlilin* (*La ilahe il Allah*) tonë, *tesbihun* (*Subhanallah*) tonë dhe *tehmidin* (*Elhamdulillah* [Të gjitha lavdërimet janë për Allahun]) tonë”.

Ai u tha: “Numëroni mëkatet tuaja. Unë ju garantoj se nuk do të humbasë asnjë nga veprimet tuaja të mira. Mjerë ti, o komb i Muhamedit (a.s.), sa shpejt do të të vijë shkatërrimi! Shokët e Profetit (a.s.) janë me shumicë, veshjet e tij nuk janë tharë akoma dhe veglat e tij nuk janë thyer akoma\*. Për Atë, në duart e të Cilit është shpirti im, ose ju jeni në udhëzim më të mirë se udhëzimi i Muhamedit (a.s.), ose po i hapni dyet kequdhëzimit (d.m.th. *bidatit*, që është risia në fe).

Ata iu përgjigjën: “Pasha Allahun, o baba i Abdur-Rahmanit, ne synuam vetëm atë që është e mirë”.

Ibn Mesudi u tha: “Sa shumë ka që synojnë të mirën, por nuk qëllojnë dot në shenjë (d.m.th. nuk e arrijnë)?!”

Pastaj ai u tha: “Profeti (a.s.) na ka thënë: “*Një grup (nga umeti im) do ta lexojë Kuranin e ai nuk do shkojë dot përtej fytit të tyre (nuk do shkojë deri në zemrat e tyre)*”. Pasha Allahun, unë nuk e di, por ka mundësi që shumë prej jush, të jenë nga ai grup”.

Dhe pastaj u largua prej tyre.

Njëri nga transmetuesit e këtij hadithi, thotë: “Ne pamë shumë nga këta njerëz, që ndodheshin në rrathë të tillë, duke luftuar kundër nesh ditën e *En-Nehrauanit* në krah të havarixhëve (betejë në të cilën Ali ibn Talibi, Kalifi i Katërt, i udhëhoqi muslimanët kundër havarixhëve, që ishin grupi i parë i muslimanëve të devijuar e me radhët e të cilëve, u bashkuan disa nga ata që u përmendën më lart).<sup>39</sup>

Nga ky rrëfim, mësojmë se ndonjëherë simptomat e devijimit mund të jenë mjaft të vogla, po pasojat që sjellin ato, janë tragjike. Dhe për çfarë? Për të synuar një gjë që mendohet se është e mirë, por “për të mos qëlluar në shenjë”. Pasimi i sunetit është shumë i rëndësishëm. Për këtë, Muhamedi (a.s.) ka thënë: “Nuk është lënë asgjë që t’ju afrojë më pranë Parajsës e t’ju largojë prej zjarrit të Ferrit, e që të mos ju jetë bërë e qartë”.<sup>40</sup> Megjithatë, sufitetë tentojnë të kërkojnë rrugë dhe mënyra, me anën e të cilave intensifikojnë adhurimin e tyre, duke rrezikuar të kalojnë caqet e vëna nga Allahu i Lartmadhëruar.

Origjina e këtij termi, ‘sufi’ nuk është aq e rëndësishme, sepse fjala “sufi” nuk përmendet as në Kuranin e as në Sunet, dhe si e tillë ajo i hap dyert sektarizmit, të cilin Allahu e dënon (shih: Kuranin, 6:159 dhe 42:13). Kjo fjalë duket ta ketë origjinën në praktikën e asketëve

<sup>39</sup> Derami (204).

<sup>40</sup> Tabaraniu, *El-Kebir* (1647).

të hershëm, që përdornin veshje të leshta, i cili njihet me fjalën “*suf*” në arabisht. Këta asketë të hershëm kishin hequr dorë nga kënaqësitë e kësaj bote, në atë masë sa, nga varfëria, ishin të detyruar që të vishnin rroba të leshta, një material jopraktik, irritues dhe tmerrësisht përvëlues në vapën e pamëshirshme të Lindjes së Mesme (ndryshe nga homologët e tyre kristianë, të cilët vishnin këmisha me lesh kali, të bindur se vuajtjet e kësaj bote ishin të barabarta me një veshje leshi, sufite të Islamit ishin thjesht tepër të varfër për të pasur mundësi që të mund të paguanin për diçka që t’i përshtatej mjedisit më mirë se sa leshi). Disa njerëzve mund t’u bëjë përshtypje kjo lloj vendosmërie dhe devotshmërie, kurse të tjerë vënë re se Islami nuk është fe e asketizmit, sepse varfëria e vuajtja e vetëshkaktuar, nuk udhëzohen dhe nuk përliqjen, nëse mund të shmangen. Në fakt, muslimanët nxiten të punojnë e ta fitojnë jetesën. Muhamedi (a.s.) thoshte: “*Vërtet, më e mira që keni ngrënë, është nga ajo që keni fituar vetë*”.<sup>41</sup> Kur e pyetën cili lloj i fitimeve është më i virtytshëm, I Dërguari i Allahut (a.s.) u përgjigj: “Puna e njeriut me duart e tij dhe të gjitha shitjet e ndershme”.<sup>42</sup> Gjithashtu, transmetohet se Ebu Derda ka thënë: “Përmirësimi i jetës së njeriut vjen nga përmirësimi i fesë së tij, dhe përmirësimi i fesë së tij vjen nga përmirësimi i intelektit të tij”.<sup>43</sup>

Sufite filluan të praktikojnë asketizmin e spritualizmin dhe me kalimin e kohës, disa udhëheqës të tyre nisën të shikoheshin si shenjtorë nga njerëzit, që përbënin pasuesit e tyre. Secili nga grupet bëhej i njohur si *tarik* (ose udhë) sufi, e për të zyrtarizoheshin mësimet të caktuara shpirtërore. Tarikatet janë shumë të ndryshme dhe nuk është e mundur të përshkruhen të gjitha me të njëjtin penel. *Akideja, ibadeti* dhe praktikat sufi variojnë shumë nga njëri grup te tjetri. Ekziston një pakicë e vogël e sufive që është në rrugën e drejtë, megjithatë, në të shumtën e rasteve, ata i kompromentojnë ligjet islame në favor të besimeve dhe të praktikave të parregullta.

Problemi i sufizmit qëndron në kalimin nga sufizmi i vjetër në sufizmin e kohëve tona. Sufite e parë mund të kenë qenë muslimanë të devotshëm, subjekte të varfërisë e privacionit, për faktin se i përqendronin përpjekjet e tyre në adhurim, duke lënë pas dore të gjitha interesat e tjera, duke përfshirë edhe ato të përmirësimit të gjendjes në këtë jetë dhe, për këtë arsye, edhe fitimin e jetesës. Megjithatë, brenda një periudhe mjaft të shkurtër kohore, u formuan tarikate të devijuara ose të çorientuara për qark mësimet të veçanta të udhëheqësve po aq të veçantë, megjithëse karizmatikë, kurse më vonë, duke u larguar nga mësimet e rrymës kryesore, nën presionet e kequdhëzimit.

Kështu, ata që anëtarësohen në tarikate, angazhohen në një rrugë me rrezik. Në kohën tonë, pak tarikate janë të sigurta nga pikëpamja islame. Si rezultat, pak aderues kthehen ndonjëherë në udhën e drejtë. Megjithatë, këngët e sirenavë të misticizmit e spiritualizmit janë tërheqëse për shumë njerëz, të cilët, duke mos qenë të bazuar në *fikhun* mbrojtës të Islamit, mund të mashtrohen e të futen në udhë të gabuar lehtësisht, një dukuri kjo, që është ende një prirje e zakonshme për të trija fetë, Judaizmin, Kristianizmin dhe Islamin.

---

<sup>41</sup> Tirmidhiu (1358), Ibën Maxhe (2290).

<sup>42</sup> Beihaku (10177).

<sup>43</sup> Xhemi’ Bejan el Ilm.

Në të trija këto fe, ata që kërkojnë udhë shpirtërore përpara se t'i përmbahen rreptësisë së ligjit, tentojnë të futen në udhë të gabuar, sepse joshen më shumë pas mësimëve spirituale të "shenjtorëve" dhe të udhëheqësve karizmatikë, sesa pas udhës së drejtë të projektit të Allahut, siç përcillet nëpërmjet Shpalljes së Tij dhe shembullit të Profetëve. Në fenë islame, këta aderues bëjnë pjesë në njërin nga të dy kampet. I pari përbëhet nga pasues të keqduhëzuar, padija e të cilëve duket tek mungesa e dijeve rreth mësimëve themelore islame. Kampi i dytë përbëhet nga aderues që janë në mënyrë paradoksale të mirë-edukuar me parimet dhe shkencat islame dhe madje mund të quhen dijetarë në fusha të caktuara të studimit. Këta individë shpesh e praktikojnë Islamin me një rigorozitet impresionues, duke iu futur rrugëve më të vështira e më të sigurta të gjitha çështjet fetare, që e përjashtojnë sufizmin. Është shumë e çuditshme që, përveç misticizmit të sufizmit, disiplina, në të cilën këta sufi dijetarë tentojnë të zbusin standardet e tyre kërkuese, në shumicën e rasteve, është në fushën më kritike të *akides*. Ata mund të jenë dijetarë në *fikh*, megjithatë aderojnë në devijim nga doktrina, duke rrezikuar shpëtimin.

Kështu, është krijuar një mori e tërë deviacionesh, më të rrezikshmet e të cilave përfshijnë *shirkun* dhe *kufrin*. Disa nga tarikatet e kanë vendosur statusin e Muhamedit (a.s.) përtej njerëzisë së tij tokësore, kurse të tjerët kanë hyjnizuar sheikët e tyre. Zbutja e standarteve islame, në interes të një pranueshmërie më të madhe, shpesh nën maskën e modernizmit, megjithëse është shqetësuese, mbetet më pak problematike.

Faktet e përmendura më lart nuk duhen parë si të çuditshme. Historia e feve dëshmon tendencën e njeriut për të lëvizur nga ligjet e Allahut drejt udhëve me pranueshmëri më të madhe, veçanërisht kur këto rrugë zbukurohen me pretendime për ekskluzivitet shpirtëror. Ashtu si ligjet strikte e kërkuese të Judaizmit Ortodoks i lëshuan udhë misticizmit të moderuar të Judaizmit Reformues, Kristianizmi pësoi një transformim prej Testamentit të Vjetër të fillimeve Unitariane drejt misticizmit indulgjent të Gnostikës, degëzim i të cilit është dhe Kristianizmi i Trinitetit. Sektet devijuese (shumica e të cilëve sufiste) që pretendojnë se janë islame, e kanë vijuar këtë traditë ngatërrimtare të rritjes së pranueshmërisë, në kundërshtim me ligjet e qarta të Islamit.

Do dëshiroja ta mbyllja këtë kapitull me këto vrojtme:

1. Shumica e atyre që kërkojnë një udhë shpirtërore, veprojnë kështu duke aspiruar të jenë *veli*, ose "miq të Allahut", që sufitetë janë të mendimit se nënkupton statusin e shenjtorit të pajisur me aftësi mistike. Këta sufi janë të pushtuar nga dëshira për të arritur një status të lartë shpirtëror, dhe supozojnë se mënyra e drejtë për ta arritur një status të tillë është nëpërmjet rrugës sufiste. Supozimi i tyre nuk është aspak i vërtetë. Rruga për t'u bërë *veli*, i cili, siç e ka përcaktuar Allahu i Lartmadhëruar, nuk nënkupton gjë tjetër, veç besimtarin dhe atë që i frikësohet Allahut (Kuran 10:62-63), është thjesht nëpërmjet zbatimit të Islamit ashtu siç është zbritur, as më shumë, e as më pak.
2. Shumica e sufive, sipas përvojës sime, kanë personalitete të çuditshme. Zakonisht, nuk duhet shumë kohë që një musliman i ri të kuptojë se diçka është bezdisshmërisht e çuditshme tek sufitetë që ata ndeshin. Kjo ka të bëjë me veçoritë e mënyrës se si ata mendojnë, megjithëse shpeshherë, kjo lidhet më shumë me



- qëndrimet e tyre të pazakonshme shoqërore. Sido që të jetë, të qënit i çuditshëm, lidhjet e pazakonta dhe afeksioni i veçantë personal, të gjitha këto, duket se janë bashkëudhëtarë të zakonshëm të sufizmit, dhe prandaj duhen marrë si shenja paralajmëruese.
3. Një tjetër karakteristikë dalluese e sufive është që, diku dhe dikur ata tentojnë që, në procesin e përbushjes së praktikave të tarikatit që kanë zgjedhur, të bëjnë kompromis me besimin dhe praktikën e Islamit. Për shembull, ka sufi që frekuentojnë shpesh mbledhjet sufiste, por që nuk merakosen asnjëherë për të marrë pjesë në atë që është mbledhja më e rëndësishme e muslimanëve, e cila është falja në bashkësi, që zhvillohet në xhami. Disa sufi i shpenzojnë pushimet dhe burimet e tyre financiare, duke vizituar “shenjtorët” e tarikatit të tyre, por nuk shkojnë kurrë për *haxh*. Ka dhe shembuj të tjerë, që tregojnë të metat në besimin dhe praktikimin e Islamit.
  4. Ashtu si shumë sufi nënvlerësojnë rëndësinë e elementeve të caktuara të fesë islame, ka të tjerë (sufitë ekstremistë, që fatmirësisht janë një minoritet mjaft i vogël) që shkojnë aq larg, sa tallen me fenë. Për shembull, disa sufi nuk falen, duke u nisur nga keqinterpretimi i ajetit kuranor **“dhe adhuroje Zotin tënd, derisa të të vijë siguria”** (Kur’an, 15:99). Këta sufi pretendojnë se “siguria” i referohet sigurisë së fesë, të cilën ata e kanë arritur, kështu që s’kanë më nevojë që të falen. Kjo nuk është e vërtetë. Muhamedi (a.s.) dhe gjithë profetët e mëparshëm të Allahut janë lutur deri në ditën e vdekjes së tyre. Mos duan të thonë këta sufi se kanë siguri më të madhe në besim sesa profetët e Allahut?! Interpretimi i saktë i *ajetit* të mësipërm është urdhri për t’u falur pesë herë në ditë tërë jetën, derisa të vdesësh. Siguria e jetës, së cilës i referohet ky *ajet* kuranor, nuk është siguria e besimit, që disa e arrijnë e disa nuk e arrijnë, por vdekja, e cila është e vetmja siguri e të gjitha jetëve. Provat për këtë kuptim, mund të gjenden në *tefsiret* (interpretimet e Kuranit) e Ibn Xherir et-Tabariut dhe Ibn Kethirit (dy nga më të famshmit e të gjithë *tefsireve*) të cilët e bazojnë këtë konkluzion në interpretimin e Kuranit nga disa prej studentëve më të famshëm të *sahabeve* (dmth Salim ibn Abdullah, Mujahid, Qatada, Al Hassan al Basri, dhe Ibn Zayd). Asnjë nga interpretuesit e famshëm të *tefsireve* midis paraardhësve të përkushtuar, nuk e ka interpretuar këtë varg siç bëjnë sufritë ekstremistë.
  5. Ashtu si në shembullin e mësipërm, shumë sufi gabojnë në të njëjtën mënyrë si çifutët e kristianët, sepse Muhamedi (a.s.) ka përcjellë shpalljen e Allahut, sipas së cilës, çifutët dhe të krishterët i konsiderojnë rabinët dhe priftërinjtë e tyre si “zota përkrah Allahut” (Kur’an, 9:31). Transmetohet se Udaj ibn Hatimi kishte hyrë njëherë te Profeti (a.s.) me një kryq të argjendtë në qafë. Kur e pa, Profeti (a.s.) recitoi këtë varg: “Ata i adhuronin rabinët dhe priftërinjtë e tyre bashkë me Allahun”. Udaj reagoi me këto fjalë: “Ata nuk i adhurojnë”. Profeti (a.s.) i tha: “Po, i adhurojnë. Ata bënë të ligjshme atë që për ta ishte e paligjshme dhe bënë të paligjshme atë që për ta ishte e ligjshme. Kështu, ata i ndoqën pas në këtë gjë. Ja, pra, si i adhuronin!”<sup>44</sup> Në të njëjtën mënyrë, shumë sufi praktikojnë mësimet liberale dhe të pasakta të udhëheqësit të tyre, duke i preferuar ato në vend të mësimëve të qarta të Profetit të Allahut, Muhamedit (a.s.). Ata i ndjekin

<sup>44</sup> Tirmidhiu (3095), Beihakiu (20137).

- udhëheqësit e tyre në gjëra të palejuara, të cilat këta të fundit i kanë shpallur të lejuara, siç është për shembull braktisja e faljeve.
6. Shumica e sufive i përlligjin veprimet dhe besimet e tyre me hadithe të sajuara ose të dobëta, apo me interpretime joautentike të Kuranit, gjë që ka qenë parashikuar nga ajeti kuranor: **“Është Ai që të ka shpallur ty (Muhamed) Librin, disa vargje të të cilit janë të qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë. Ato janë themelet e Librit. Kurse disa (vargje) të tjera janë jo krejtësisht të qarta (me kuptime alegorike). Ata, zemrat e të cilëve prirën nga e pavërteta, ndjekin vargjet më pak të qarta, duke kërkuar të krijojnë pësjtjellim dhe duke kërkuar t’i komentojnë sipas dëshirës...”** (Kur’an, 3:7).
  7. Sufitë tentojnë të prirën drejt teprimeve, shpeshherë duke zmadhuar rëndësinë e ngjarjeve ose të personave. Me anë të kësaj prirjeje, ata kanë shkuar aq larg saqë e kanë ekzagjeruar statusin e Muhamedit (a.s.), të anëtarëve të familjes së tij, madje edhe të udhëheqësve që pretendojnë se kanë ardhur në gjurmët e tyre (brenda *tarikatis* të tyre të veçantë, sigurisht). Ndonjëherë, kjo shpie në *shirk*, herë të tjera në *kufir* dhe, jo rrallë në të dyja. Për shembull, një sufi u përpoq njëherë të më bindte se aderuesit në *tarikatin* e tij bëjnë *ibadet* deri sa bëhen, sipas fjalëve të tij, “një me Allahun” – një pohim i qartë si i *shirkut*, ashtu edhe i *kufrit* (edhe sikur të përdorej në kuptim metaforik). Në fenë islame, nëse një burrë i shqipton divorcin gruas së tij, qoftë edhe duke e pasur me shaka, ata konsiderohen të divorcuar! Në ligjin islam, divorci është një çështje kaq serioze, saqë nuk mund të shqiptohet pa u bërë detyrues, qoftë dhe kur bëhet shaka! Kur është kështu për divorcin, çfarë mund të thuhet për Njësimin e Allahut e cila është kaq e shenjtë, sa dhe shpëtimi varet nga vlerësimi i këtij parimi thelbësor të besimit?
  8. Shumë sufi pretendojnë një zinxhir mistik mësimesh, që e ka origjinën tek ndonjë *sahab*, mbi të cilin themelohen mësimet e *tarikatis* të tyre. Për shembull, një “shejh” sufi në Angli njihet nga pasuesit e tij si “hallka e dyzetë e zinxhirit të artë”, me të cilën nënkuptohet se ai është shejhu i dyzetë sufi, në një zinxhir që e ka origjinën tek Profeti Muhamed (a.s.). Por këto frazeologji ekstravagante nuk e ndryshojnë realitetin, sepse në pjesën më të madhe të tyre, këtyre “zinxhirëve” nuk mund t’u gjenden rrënjët më herët se para 300 vjetëve, gjatë të cilëve ndeshen emra personash të panjohur e të diskutueshëm për veprimtari dhe reputacion jo dhe aq të respektuar.
  9. Ndërkohë që në kohën e sotme ka shumë tarikate sufi devijuese, pak prej tyre janë në rrugë të drejtë. Kush i futet kësaj rruge, vë në rrezik shpëtimin e tij, dhe për çfarë? Rruga më e sigurtë është e qartë, kurse rruga sufi është e rrëshqitshme dhe mashtruese, me përfitime të papërfillshme dhe mësimet që në rastin më të mirë janë të dyshimta, e në më të keqin pabesim. Muhamedi (a.s.) ka thënë: “E lejuara dhe e ndaluara janë të qarta. Mes të dyjave ka gjëra që janë të dyshimta për shumë njerëz. Prandaj, ai që i shmang këto gjëra të dyshimta, e qartëson veten në lidhje me fenë dhe me nderin e tij. Kurse, ai që bie në gjëra të dyshimta, bie në gjëra të ndaluara. [Ai është] sikurse bariu që i kullot dhentë e tij në kufijtë e një prone, gati për të kaluar në pronën e tjetrit...”<sup>45</sup> Mjerë ata që dhunojnë gjërat e ndaluara nga Allahu, qofshin vetëm, apo pas bishtit të ndonjë *tarikati*.

<sup>45</sup> Buhariu (52), Muslimi (1599), Ebu Daudi (3329).

## 6. SUNETI I SHEJTANIT

Rruga e të devotshmëve e shpie një person në garën midis së mirës e së keqes. Ndërsa e mira, që konsiston në besimet e praktikat e fesë, i mësohet herë pas here të sapokthyerit në Islam, një nga subjektet më të rëndësishme për të është dhe ai që diskutohet më pak: rruga e së keqes. Me rrugë të së keqes nënkuptojmë rrugën (*sunetin*) e *Shejtanit* (Djalli, i njohur edhe me emrin *Iblis*, qëllimi i të cilit (bashkë me ndihmësit e tij, *shejtanët* [xhindët e këqinj, djajtë]) është që ta orientojë njerëzimin në udhë të gabuar. Të mësosh besimet dhe praktikat e fesë, do të thotë të mësosh rrugën e përkushtimit. Të mësosh sunetin ose rrugën e Iblisit, do të thotë “të njohësh armikun”, me qëllim që ta mbrosh veten nga pritrat e tij apo nga futja në udhë të gabuar.

Iblisi shfaqet në shumë mënyra. Për ata që tashmë janë në rrugë të gabuar, ai siguron përkrahje, duke e bërë të lehtë dhe joshëse rrugën e mohimit të devotshmërisë fetare. Ai mund të zgjedhë ta lërë vetëm atë që është në rrugën e gabuar, po pastaj mund t’i sigurojë përsëri kënaqësi të vërteta apo edhe përvoja mistike ose mrekulli të dukshme, me qëllim që ta konsolidojë të keqdhëzuarin në atë rrugë. Kështu, statujat mund të qajnë vërtet nëpërmjet makinacioneve të djajve, duke i çuar adhuruesit e idhujve në një devotshmëri më të madhe në thellësitë e trukeve të tyre pagane. Vizionet e Jezuit e të Marisë mund të gjenerohen vërtet nga Iblisi apo nga ndonjë prej djajve të bashkuar me të, me qëllim që të përforcojnë besimet e keqdhëzuara, që qëndrojnë prapa objekteve të idhujtarisë, të tilla si: Triniteti apo apoteoza e Jezuit. Në një shkallë më të vogël, mund të nxitet krenaria e pabesimtarit, me qëllim që të konsolidohet besimi tek falsiteti, duke asfiksuar, kështu, modestinë që i duhet njeriut, për t’u kthyer me sinqeritet dhe ndershmëri drejt Krijuesit.

Por, cili ishte mëkati i parë? Kjo pyetje turbullon shumicën e të sapokthyerve, si dhe shumë muslimanë me përvojë. Vërtet ishte ngrënia e frutit të ndaluar? Jo! Mëkati i parë ka qenë mëkati i krenarisë, për të cilin Iblisi u largua nga Parajsa. Mëkati i parë nuk ishte i Adamit, por i Iblisit, dhe historia shkurtimisht është kjo: Iblisi ka qenë një nga xhindet e përkushtuar. Ai i praktikonte kushtet e adhurimit me një devotshmeri të atillë, sa që kishte merituar një vend në shoqërinë e engjëjve, dhe, në fakt, ishte caktuar nga Allahu që të administronte qiellin më të ulët. Por, kur u krijua Ademi e banorët e qiellit u urdhëruan të binin në sexhde përpara tij, Iblisi u ndie krenar, duke menduar se ishte më i mirë e duke gjykuar që xhindet ishin bërë prej zjarrit pa tym, kurse njeriu ishte bërë prej balte. Kurani i Shenjtë e tregon kështu këtë histori:

***“Kur u thamë engjëjve: “Përluni në sexhde para Ademit”, ata u përlën, përveç Iblisit, i cili nuk desh, u tregua mendjemadh dhe u bë mosbesimtar”***  
(Kur’an, 2:34).

Në një ajet, Allahu na informon se Iblisi nuk pranoi e arsyeja ishte krenaria. Rezultati i saj ishte mosbesimi. Sa shpejt mund të bjerë nga mëshira në pabesim një besimtar! Për asnjë arsye tjetër, përveç krenarisë, e cila mjafton ta pjekë frytin e së keqes! Në Kuran thuhet:

**Allahu tha:** “Çfarë të pengoi ty të mos përuleshe, kur të urdhërova?” Ai u përgjigj: “Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijove nga zjarri, kurse atë e krijove nga balta” (Kuran, 7:12).

**Allahu i tha:** “Atëherë, zbrit prej andej (Xhenetit)! Ti nuk ke të drejtë që të krenohesh në të! Shporru, me të vërtetë, ti je prej të poshtëruarve”. (Kuran, 7:13).

**Iblisi tha:** “Më jep afat deri në ditën kur ringjallen njerëzit” (Kuran, 7:14).

**Allahu i tha:** “Ti je nga ata që u është dhënë afati” (Kuran, 7:15).

**Ai tha:** “Për shkak se Ti më flake tej, unë do t’u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë (Kuran, 7:16)

**e do t’u qasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e djathta dhe nga e majta, e kështu Ti do të vëresh se shumica e tyre nuk të janë mirënjohës!”** (Kuran, 7:17)

**Allahu i tha:** “Dil prej andej i përbuzur dhe i përjashtuar! Pa dyshim, Xhehenemin do ta mbush me ty dhe me të gjithë ata që shkojnë pas teje!” (Kuran, 7:18)

Si ndëshkim për krenarinë e tij, që pengoi bindjen ndaj Allahut të Lartmadhëruar, Iblisi u flak jashtë Parajsës. Pasi siguroi afat nga Allahu deri në Ditën e Gjykimit, Iblisi u betua që ta fuste në udhë të gabuar njerëzimin, për ta nxjerrë nga ‘rruga e drejtë’. Sa për ata që pasojnë kequdhëzimin e Iblisit, Allahu premtoi: “Unë do ta mbush Ferrin me të gjithë ju bashkë”.

Tani të kthehemi tek njeriu që i lexon këto fjalë. Cila është një nga karakteristikat më të përhapura të njerëzimit? Cila pengesë qëndron midis shumicës së njerëzve dhe kthimit drejt Zotit me përlësi, në kërkim të së vërtetës së Tij? Përgjigjja është: Krenaria! Sa shpejt mund ta kthejë krenaria një njeri nga besimi në mosbesim? Nga parajsa në humbje? Tmerrësisht shpejt, mjafton të kemi parasysh ato që u thanë më lart.

Cilat dobësi të tjera të natyrës njerëzore sigurojnë linja plasaritjesh, nga ku shejtani mund të infiltrojë mosbindjen ndaj Krijuesit? Zilia është një. Lakmia një tjetër. Dëshira, dëshpërimi, pakënaqësia, padurimi, pasioni seksual dhe zemërimi janë të tjera. Madje edhe kënaqësia, nëse lejohet ta çojë një person në plogështi. Edhe krenaria. Në fillim, në fund dhe në të gjitha pikat midis tyre.

Le të shohim se si funksionon një gjë e tillë. Para se gjithash, Iblisi ose shejtani ka disa prioritete. Në fillim, ai përpiqet që të gjejë njerëz që kryejnë *kufr*. Nëse ai nuk mund të gjejë njerëz që të kryejnë *shirk*, ai provon t’i fusë ata në kryerjen e *shirkut* të vogël. E nëse dështon dhe këtu, ai mundohet që t’i çojë njerëzit në kryerjen e *bidateve* (risive). Nëse nuk ka sukses as këtu, përpiqet t’i fusë njerëzit në kryerjen e mëkateve të mëdha; e nëse nuk ia del, atëherë në mëkate të vogla. Por, çdo të ndodhte nëse nuk do mund të gjente njeri, që të kryente qoftë edhe një mëkat të vogël? Mbase atëherë shejtani do të provonte që të zhvlerësonte një punë të mirë, për shembull duke nxitur një ndjenjë

krenarie, duke e bërë njeriun të prirur që të duket, ose duke e motivuar nëpërmjet lakmisë që të kërkojë më shumë fitime të kësaj bote sesa kënaqësinë e Allahut. Të gjitha këto gjëra mund të bëjnë që Allahu të mos e pranojë punën e mirë të një njeriu. Muhamedi (a.s.) thotë se tre njerëzit e parë që do të flaken në Zjarrin e Ferrit në Ditën e Gjykimit, janë një dijetar, një njeri që ka dhënë lëmosha e një martir, te cilët ia kanë kushtuar veprën e tyre dikujt tjetër veç Allahut. Hadithi është ky:

Ebu Hurejre tregon se Profeti (a.s.) ka thënë: “Në të vërtetë, Allahu i Lartësuar do të zbresë tek robërit e Tij në Ditën e Gjykimit dhe do gjykojë midis tyre. Të gjitha kombet do të përulen më gjunjë. Njerëzit e parë që do të thirren për të dhënë llogari në Ditën e Gjykimit, do të jenë një dijetar e recitues i Kuranit, një martir që është vrarë për çështjen e Allahut, si dhe një person i pasur (që e kishte zakon të jepte vazhdimisht nga pasuria e tij). Allahu do ta pyesë dijetarin e recituesin e Kuranit: “A nuk të kam mësuar atë që i është shpallur të Dërguarit Tim?” Dhe ai do të përgjigjet: “Po!” Atëherë, Allahu do ta pyesë: “Çfarë ke bërë me atë që të kam mësuar Unë?” Ai do të përgjigjet: “E kam recituar ditë e natë [dhe kam kërkuar dije e ua kam mësuar njerëzve]”. Atëherë, Allahu do t’i thotë: “Jo, ti gënjen!” dhe engjëjt do të thonë: “Jo, ti gënjen!” Allahu do të thotë pastaj: “Ti vetëm ke dashur që njerëzit të mendojnë për ty se je dijetar dhe recitues i Kuranit dhe kështu të kanë menduar!” Do të vijë njeriu me pasuri të madhe, e Allahu do t’i thotë: “A s’të bekova në mënyrë që të mos ishe i varur nga të tjerët?” Ai do të përgjigjet: “Po!” Allahu do ta pyesë: “Çfarë ke bërë me atë që të dhashë?” Ai do të thotë: “Kam plotësuar detyrimet ndaj familjes sime dhe i kam shpenzuar paratë e mia për mëshirë”. Por, Allahu do t’i thotë: “Jo, ti gënjen!” dhe engjëjt do të thonë: “Jo, ti gënjen!” Allahu do të thotë pastaj: “Ti vetëm ke shpenzuar që njerëzit të të quajnë bujar, dhe kështu të kanë quajtur!” Do të pyetet njeriu që vdiq në udhën e Allahut: “Si ke vdekur ti?” Ai do të përgjigjet: “Zoti im! Unë u urdhërova të bëja xhihad në udhën Tënde, dhe kështu luftova derisa u vrava”. Allahu do t’i thotë: “Jo, ti gënjen!” dhe engjëjt do të thonë: “Jo, ti gënjen!” Allahu do të thotë pastaj: “Ti ke luftuar vetëm që për ty të thuhet se ishe trim i madh, dhe kështu është thënë!”

Ebu Hurejra vazhdon: “Pastaj, Profeti (a.s.) më ra lehtë mbi gjunjë e tha: “O Ebu Hurejre! Këta janë tre njerëzit e parë nga krijesat e Allahut, që do të digjen në zjarrin e Ferrit në Ditën e Gjykimit!”<sup>46</sup>

Veprat e mira, nëse i dedikohen një tjetri e jo Allahut, kanë për t’u refuzuar, dhe ky është një tjetër shembull i gjykimit të veprimit sipas qëllimit. Nëse dijetarët, të mëshirshmit dhe martirët, nuk janë të sigurve nga qëllimet e keqorientuara, atëherë ç’mund të thuhet për të tjerët?

Nëse dështon gjithçka tjetër, Iblisi mund të përpiqet ta qetësojë njeriun në vetëkënaqësinë e tij, sepse ndjesia e të qenit mirë (besimi i mbivlerësuar se janë bërë mjaftueshëm vepra të mira), mund të jetë hapi i parë i rënies së një njeriu nga lartësitë e devocionit fetar. Ata që nuk mund të bien në rrënim të plotë, Iblisi mund të përpiqet që t’i çojë drejt këtij rrënimi dalëngadalë.

<sup>46</sup> Muslimi (1905), Tirmidhiu (2382), Nesai (3137).

Por, nëse një person këmbëngul në udhën e drejtë, shejtani sërish nuk dorëzohet, sepse ai mund të ndikojë akoma, duke i larguar njerëzit nga veprat e mira, me vlerë më të madhe, në drejtim të kryerjes së veprave të mira me vlerë më të vogël. Në fund të fundit, dita është e gjatë.

Pra, njeriu duhet të jetë vigjilent dhe të mos dëshpërohet. Duke ditur se jeta me devotshmëri fetare shoqërohet me luftën kundër forcave të së keqes, ku Iblisi e ballafaqon njeriun me një mpleksje tundimesh të jashtme e dëshirash të brendshme, kjo e ndihmon njeriun që të përgatitet për këtë përpjekje. Vetëdija se Iblisi nuk dorëzohet asnjëherë derisa shpirti të ikë nga trupi, e ndihmon njeriun të angazhohet në durim dhe qëndrueshmëri. Gjithashtu, duke ditur se Allahu e krijoi njerëzimin të papërsosur, e ndihmon njeriun që të mos bjerë në dëshpërim, sepse prova e besimit të njeriut në mirësinë e Allahut, qëndron jo në arritjen e të paarritshmes (d.m.th. të përsosjes), por më shumë, në ndihmën e Allahut për pranimin e pendimit, kur bëhet gabim. Problemi i mospranimit nga disa, i prirjes njerëzore për të gabuar, qëndron në faktin se ata e shikojnë fenë si një regjim diete. Me ta thyer dietën vetëm me nje fletë marule më shumë, ata mendojnë se e kanë prishur regjimin dhe se gjithçka ka marrë fund dhe që tani mund të mbarohet komplet kutia me çokollata, e bile ta pasojnë edhe me ndonjë litër verë. Ky mund të jetë fati i dietës, por jo edhe i fesë, sepse ashtu siç thotë Jakubi (a.s.): **“...shpresën në mëshirën e Allahut nuk e humb askush, përveç jobsimtarëve”** (Kur’an, 12:87).

Natyrisht, Allahu mund ta kishte krijuar njerëzimin të lirë nga gabimet, ashtu sikurse engjëjt. Por, ndryshe nga engjëjt, qënieve njerëzore u është dhënë vullnet i lirë, në mënyrë që thelbi i ekzistencës së tyre të jetë adhurimi dhe shërbimi vullnetar ndaj Allahut, si dhe rikthimi i penduar tek Allahu, sa herë që bien në gabim.

Megjithatë, për disa, kjo nuk është e mjaftueshme. Për disa, jeta qeveriset nga një kërkim i vazhdueshëm për një domethënie më të madhe të ekzistencës. Këta individë shpeshherë tërhiqen në misticizëm, sepse nëpërmjet tij, atyre u duket se arrijnë një vetëdije të lartësuar shpirtërore dhe një afrimitet më të madh me Allahun. Ja ku del shejtani përsëri! Pasi mësuam, tashmë, mëkatin e parë të Iblisit, cili është mëkati i parë i Ademit? Dihet historia e ngrënies së frutit të ndaluar nga pema. Po pse, pikërisht, e bëri Ademi këtë gjë? Cili ishte motivi i tij? Përgjigjen e gjejmë në Kuran, në Suren 7, ajetet 20-21, ku Iblisi tregohet ta ketë këshilluar Ademin në këtë mënyrë:

**“Djalli u pëshpëriti, për t’ua zbuluar pjesët e turpshme të mbuluara të trupit të tyre dhe u tha: “Zoti juaj jua ka ndaluar pemën, vetëm që të mos bëheni engjëj ose të pavdekshëm”. Dhe iu betua atyre [duke thënë]: “Vërtet, Unë jam për ju këshillues i singertë”.**

Dhe Ademi i besoi, pavarësisht faktit se Allahu e kishte paralajmëruar më parë që të ruhej nga Iblisi. (... dhe Zoti i tyre i thirri: **“A nuk jua kisha ndaluar atë pemë? A nuk ju pata thënë se djalli është vërtet armiku juaj i hapët?”** (Kur’an, 7:22).

Pra, natyra e njeriut, qysh nga fillimi, ka qenë e tillë, që arsyeja të mund të mposhtet nga ambicja e tij, për gjendje më të larta shpirtërore (për statusin e engjëjve apo të të “të

pavdekshmit”). Shejtani vazhdon të luajë me këtë dobësi të shumë muslimanëve, ashtu siç bëri edhe me Ademin. Dhe muslimanët janë paralajmëruar njësoj si Ademi.

Ndërkaq, në të gjitha kohët, ka patur përherë nga ata që kanë qenë të etur për të kafshuar mollën e misticizmit e të apoteozës. Disa kanë qenë aq entuziastë, saqë e kanë tepruar me fenë, duke i hyjnizuar elementet e krijuara nga Allahu. Një sekt i çifutëve e konsideronte Uzejrën si bir të Zotit, shumë kristianë e nderojnë Jezu Krishtin ose si bir të Zotit, ose si partner të Tij, kurse disa anëtarë të shiitëve ekstremë, kanë shkuar aq larg sa të hyjnizojnë Aliun. Megjithatë, grupet më të mëdha erdhën te drejtimit e gabuara nga ligjet e Judaizmit, Kristianizmit e Islamit, nëpërmjet reformës, gnostikëve dhe lëvizjeve sufiste, përkatësisht, ashtu sic e përshkruam më lart. Fakti që këto tendenca, kanë qenë të njëjta për të trija besimet abrahamike, tregon se Iblisi ka gjetur një mënyrë që funksionon për të drejtuar në udhë të keqe, të cilën e ka përdorur në mënyrë të përsëritur në të gjitha fetë dhe në të gjitha kohët: *“Përqaqfoni misticizmin, lëreni fenë! Përqaqfoni misticizmin, lëreni fenë! Unë jam këshilluesi juaj i sinqertë”*.

## 7. “KËSHILLUESIT E SINQERTË”

Ata që bëjnë thirrje për në udhë të gabuar, kanë shumë fytyra dhe futen nëpërmjet shumë dyerve, por thuajse gjithmonë, e paraqesin veten si këshillues të sinqertë. Sfida për të gjithë muslimanët është që të mësojnë saktësinë e besimit e të praktikave të Islamit, sepse kjo përcakton rregullin, me anë të të cilit, mund të njihen e të vlerësohen individët dhe grupet devijatore. Nga ana tjetër, ata që i kundërvihen fesë islame janë sugjerues, sepse është e arsyeshme të supozohet që antagonistët e fesë, nuk i mbështesin individët dhe grupet që përfaqësojnë Islamit e vërtetë. Kështu, kur grupet anti-islame të interesit, përkrahin një sekt ose ideologji të caktuar nën maskën e “Islamit”, muslimanët duhet ta shikojnë mbështetjen e tyre me dyshim.

Të gjitha publikimet e rretheve qeveritare perëndimore përhapin paragjykime serioze, njësoj si mediat perëndimore, që priren mirënjohëse drejt interesave të grupeve jo-islamike. Si shembull ilustrues mund të përmendim Islami Civil Demokratik i Cheryl Bernardit (i disponueshëm në website [www.Rand.org](http://www.Rand.org)), Departamenti i Kërkimeve për Sigurinë Kombëtare i Rand Corporation, një nga arsenalet e politikës perëndimore.

Traktati i Bernardit fillon në këtë mënyrë:

“Nuk ka dyshim që Islami bashkëkohor është në gjendje të paqëndrueshme, i angazhuar në luftë të brendshme e të jashtme lidhur me vlerat, identitetin dhe vendin e tij në botë. Versionet rivale garojnë për dominim shpirtëror dhe politik. Ky konflikt ka kosto serioze dhe implikime ekonomike, shoqërore, politike dhe të sigurimit për pjesën tjetër të botës. Për pasojë, Perëndimi po bën një përpjekje të madhe për të arritur një marrëveshje, për të kuptuar dhe për të influencuar përfundimin e kësaj lufte”.<sup>47</sup>

Perëndimi “po bën një përpjekje ... për të influencuar përfundimin e kësaj lufte”? Drejt e në shenjë! Tepër e qartë. Kështu, duke kujtuar që punimi i Bernardit është bërë për dijetarët dhe politikanët, le ta marrim prej andej (Oh, dhe vetëm sa për sqarim, që ky nuk është ndonjë traktat i panjohur në rrethet e plitikanëve. Një kërkim në databeisin e Rand Corporation pikërisht në website-in e tyre për fjalën “Islam” nxjerr Islamit Civil Demokratik të Bernardit, pikërisht, si rezultat të saj të parë, të zgjedhur për nga rëndësia në pikëpamje të shkrimit të këtij libri).

Kështu, duke vazhduar, Bernardi vazhdon ta ndajë botën muslimane në katër ndarje të gjera, që janë fundamentalistët, tradicionalistët, modernistët dhe sekularistët. E meqë fundamentalistët, si përkufizim, janë ata që aderojnë më pranë themeleve të Islamit, nuk është për t’u habitur që ata shikohen nga autorja në mënyrë të pafavorshme. Sipas fjalëve të saj, “mbështetja e tyre s’është opsion, përveçse për konsiderata të përkohshme taktike”.<sup>48</sup>

<sup>47</sup> Benard, Cheryl. *Civil Democratic Islam*. Rand Corporation. P. ix

<sup>48</sup> Benard, p. x.



Zonja Bernard vazhdon me pohimin që tradicionalistët nuk janë për t'u besuar, kurse “modernistët e sekularistët janë më të afërm me Perëndimin për nga vlerat e politikat”.<sup>49</sup> Për këtë arsye autorja rekomandon që duhen mbështetur modernistët dhe sekularistët, kurse fundamentalistët duhen kundërshtuar e konfrontuar, duke i përdorur tradicionalistët si kundërpeshë ndaj fundamentalistëve, me qëllim që kundër fundamentalistëve të hapet luftë nga të dy frontet – si nga jashtë, ashtu edhe nga brenda fese.<sup>50</sup>

E gjitha kjo duhet t'u sugjerojë muslimanëve që të zgjedhin prioritete krejt të kundërta e të ndjekin një strategji relativisht të kundërt.<sup>51</sup>

Po kështu, autorja rekomandon “të nxitet popullariteti e pranueshmëria e Sufizmit”,<sup>52</sup> që për muslimanët do të thotë ‘mos’, si në ‘mos, mos, mos’. Dhe për një arsye të shëndoshë. Sufitë (të cilët në librin e Benard klasifikohen si nëngrup i modernistëve<sup>53</sup>), modernistët e sekularistët kanë liri të pabesueshme në interpretimin e Kuranit e të Sunetit, mbështeten në arsyetime të pavarura dhe selektive në përpjekje të kota për ta formatuar Islamin sa më pranë dëshirave të tyre të zemrës, dhe mbështetin fuqimisht njëri-tjetrin, ndërkohë që denigrojnë të gjithë ata që mbrojnë metodologjinë e salaf-it (paraardhësve të devotshëm, që janë tre të parët dhe më të mirët e brezave që ndoqën shpalljen e Kuranit të Shenjtë dhe misionin lajmëtar të Muhamedit (a.s.)).

E ndërsa këshilluesit “e sinqertë” janë të shumtë, vlerësimi i perspektivës dhe i orientimit të tyre, ndihmon për të dalluar midis atyre që duhen respektuar, atyre që duhen shmangur dhe atyre që duhen kundërshtuar.

---

<sup>49</sup> Benard, p. x.

<sup>50</sup> Kur përdoret literalisht, termi “muslimanë fundamentalistë” u referohet atyre që aderojnë në themelet e Islamit. Megjithatë, në përdorimet e përditshme termi evokon imazhet e ekstremistëve militantë muslimanë. Siç e kuptoj unë tezën e zonjës Benard, ajo u referohet të dy grupeve me të njëjtin emërtim: “Fondamentalizëm”. Po kjo është e pandershme dhe e pasaktë, në të njëjtën kohë. Në fakt, fundamentalistët e vërtetë muslimanë, që nënkuptojnë ata muslimanë që aderojnë në mësimet e Islamit të vërtetë, i kanë dënuar ashpër ekstremistët militantë dhe muslimanët radikalë, të cilët kanë bërë kaq shumë krime kundër njerëzimit dhe kundër vetë fesë islame. Puna është se, nëse zonja Benard pohon se duhen kundërshtuar ekstremistët militantë muslimanë (fondamentalistët muslimanë, në sensin e përditshëm), atë do ta miratonte edhe shumica e muslimanëve që e praktikojnë Islamin në mënyrë strikte (muslimanët fundamentalistë në kuptimin literal). Por nëse ajo nënkupton se duhen kundërshtuar muslimanët që e praktikojnë Islamin në mënyrë strikte, asnjë musliman i vërtetë nuk mund të binte dakord me të, sepse përkushtimi ndaj Islamit kërkon aderencë ndaj mësimave të tij.

<sup>51</sup> Por pa rënë në gabimin e ekstremistëve militantë, apo siç njihet tani, ‘të Islamit radikal’.

<sup>52</sup> Benard, p. 80.

<sup>53</sup> Benard, p. 62.

## 8. PËRMBLEDHJE

Shumë të kthyer në Islam futen në fe me një ndjenjë të thellë çlirimi, të shoqëruar me ndjesinë e arritjes së të vërtetës dhe fundit të kërkimeve të tyre. Këto ndjesi përlligjen në një farë mënyre, por gjithsesi, udhëtimi i tyre është akoma në fillimet e tij. Puna është se feja e Islamit është ndarë një një larmi sektesh dhe udhësh të keqduhëzuara, më të rëndësishmet e të cilave janë prekur në diskutimin e bërë më lart.

Në shumë pikëpamje, kthimi i ngjan arritjes, pas një udhëtimi të gjatë e të vështirë, në një qendër të madhe qarkullimi si ajo e stacionit ‘Grand Central’ në qytetin e Nju Jorkut, stacionit ‘Victoria’ në Londër, apo një tjetër nga të shumë stacioneve gjigande hekurudhore apo aeroportive ndërkombëtare, që gjenden anë e mbanë botës. Pasi arrin, provon një ndjesi lehtësimi, një ndjesi paqeje, madje edhe gëzimi. Megjithatë, këto emocione janë kalimtare, sepse duhet bërë zgjedhja dhe të vazhdohet udhëtimi. Numri i rrugëve lidhëse, që degëzohen që nga stacioni qendror (stacioni i Islamit) janë të shumta, por vetëm njëra është e duhura (rruga e projektuar nga Zoti, pra ajo, në të cilën kanë ecur Muhamedi (a.s.) dhe shokët e tij). Sigurisht, zgjedhjet e gabuara mund të rekuperohen, por me një kosto tipikisht të lartë, dhe do të ishte shumë më mirë të kapej qysh në fillim lidhja e duhur.

Pra, i sapokthyeri duhet të përgatitet për t’u ndeshur me zgjedhje të shumta, që në pamje të parë mund të duken hutuese dhe ngatërrimtare. Megjithatë, për fat të mirë, feja islame është e lehtë dhe e thjeshtë. Nuk është feja e vështirë dhe hutuese, por janë më shumë një numër individësh, të cilëve u mungojnë dijet dhe ekuilibri, që e bëjnë fenë të vështirë dhe të ashpër. Rezultati i propagandimit të fesë në këtë mënyrë ka pasoja të rënda, më e vogla nga të cilat është konfuzioni dhe grindja, dhe më e madhja – heqja dorë nga feja.

Duke ditur rreziqet, besimtarët bëjnë mirë të kthehen në mënyrë të vazhdueshme me besim e kujtim drejt Allahut, qoftë duke u penduar për një shkelje, apo duke kërkuar ndihmë kundër vështirësive. Besimtarët besojnë se Allahu i përgjigjet lutjes së tyre me atë që Ai e di se është më e mira. Allahu i Lartmadhëruar thotë:

***“... i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t’i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë”*** (Kuran, 2:186).

Besimtarët e vërtetë nuk e humbasin kurrë shpresën, sepse ata kanë besim se përderisa Allahu i ka çuar aq larg, Ai nuk do t’i braktisë kurrë, për aq kohë sa ata do të mbështeten tek Ai dhe vetëm tek Ai. Muslimanët e përsërisin këtë besim sa herë luten, duke recituar surenë El Fatiha dhe duke pohuar: ***“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”***, në vazhdim të së cilës, muslimani kërkon udhëzimin e Allahut për në ***“rrugën e drejtë”***. Kjo është lutja më e rëndësishme dhe ajo, së cilës besimtarët janë të bindur se Allahu do t’i përgjigjet.

Pra, le të lutemi:

**Allahu na udhëzofte të gjithëve e na ndihmoftë të përqendrohemi tek e vërteta dhe e drejta, tek pastërtia dhe devotshmeria fetare. Allahu u dhëntë durim dhe**

**vendosmëri të gjithë muslimanëve në rrugën e drejtë dhe të bekuar të caktuar prej Tij në këtë jetë, dhe na bekoftë me lumturinë e Parajsës në jetën tjetër!  
Amin!**

Dhe pasi të kemi thënë këtë, le të punojmë dhe të bëjmë atë që na takon.

## **FJALOR TERMASH**

**Akide** – doktrinë.

**Ajet** – varg i Kuranit të Shenjtë.

**Bidat** – risi.

**Dave** – ftesë.

**Dynja**– jeta e kësaj bote.

**Farz** – I detyrueshëm.

**Fetva** – Verdikt ose gjykim ligjor.

**Fikh** – Literalisht “dije”. Fjala “fikh” përdoret për të nënkuptuar dijen për ligjet islame.

**Hadith** – Traditë që regjistron fjalët, veprimet, paraqitjen dhe pëlqimet e nënkuptuara të Muhamedit (a.s.).

**Hallall** – I lejuar.

**Haram** – I ndaluar.

**Haxh** – Pelegrinazhi vjetor musliman në Mekë.

**Hixhre** – Migrimi i muslimanëve nga Meka në Medinë në Korrik të vitit 622 e.r.

**Ibadet** – Adhurim.

**Iblis** – Emri i shejtanit.

**Ihsan** – Vetëdije për Zotin.

**Imam** – Drejtues i lutjeve, ai që del në krye të bashkësisë së lutësve.

**Iman** – Besim.

**Ixhma** – Konsensus (i dijetarëve).

**Ixhtihad** – Arsyetim i pavarur (për të arritur një gjykim).

**Medhheb** – Shkollë e mendimit.

**Mekë** – Qyteti i shenjtë, në të cilin muslimanët bëjnë pelegrinazh. Qabeja, drejt së cilës muslimanët drejtojnë lutjet, dhe pusi i Zem-Zemit ndodhen në xhaminë e shenjtë qendrore.

**Sahab** – Shok i Profetit Muhamed (a.s.).

**Selefët** – Paraardhësit e përkushtuar, që i referohet tre gjeneratave të para pas profetësisë së Muhamedit (a.s.).

**Sure** – Kapitull i Kuranit të Shenjtë.

**Shehadet** – Dëshmia e besimit islam.

**Sheriat** – Ligji islam.

**Shirk** – Mohim i *tevhidit* (monoteizmit islam).

**Teube** – Pendim.

**Tevhid** – Monoteizmi islam.

**Ulema** – Korpusi i dijetarëve të Islamit.

**Umet** – Komb, popull.

**Umre** – Pelegrinazh vullnetar në Mekë.

**Zekat** – Taksë për të varfërit.

## PËRMBAJTJA

Hyrje.....	.....
Angazhimi .....	.....
Grupi i shpëtuar.....	.....
Shtyllat.....	.....
Dallimet.....	.....
Dijetarët dhe Fikhu (Jurisprudenca islame).....	.....
Praktika.....	.....
Ihsani (Perceptimi i Zotit).....	.....
Sufizmi.....	.....
Suneti i shejtanit.....	.....
“Këshilluesit e sinqertë”.....	.....
Përmbledhje.....	.....
Fjalor termash.....	.....
Përmbajtja.....	.....